



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 9

Tiranë – E mërkurë, 25 janar 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 20, datë 18.1.2017	Për mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit të shërbimit të jashtëm dhe familjarëve që i shoqërojnë ata gjatë kohës që dërgohen me shërbim në misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit..... 225
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 21, datë 18.1.2017	Për sigurimin shëndetësor të veçantë të punonjësve të disa strukturave të Policisë së Shtetit..... 228
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 22, datë 18.1.2017	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Punëve të Brendshme, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore për viktimat e ngjarjes së 21 janarit 2011..... 228
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 26, datë 18.1.2017	Për miratimin e ndryshimit nr. 2 të marrëveshjes së grantit nr.TF013972, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve grant, të siguruara nga dhurues të ndryshëm, nën fondin e dytë të besimit shumëdhurues për Shqipërinë, për mbështetjen për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) 2..... 229
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 30, datë 18.1.2017	Për miratimin e marrëveshjes shtesë të koncesionit “Për disa ndryshime dhe shtesa në marrëveshjen e koncesionit lidhur me projektimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e një projekti për një hidrocentral të ri në Ashtë, Republika e Shqipërisë, ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (Autoriteti Kontraktues) dhe VERBUND AG (Koncesionari) dhe Energji Ashta sh.p.k. (Shoqëria e projektit)”, miratuar me vendimin nr. 1363, datë 17.10.2008, të Këshillit të Ministrave..... 231
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 18.1.2017	Për një shtesë në vendimin nr. 824, datë 6.12.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e institucioneve të autorizuara për verifikimin, në mënyrë elektronike, të gjendjes gjyqësore, si dhe të formularit të vetëdeklarimit”, të ndryshuar..... 238

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 32, datë 18.1.2017	Për shpalljen e Qendrës Historike të qytetit të Përmetit dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth.....	238
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 33, datë 18.1.2017	Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit.....	248
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 34, datë 18.1.2017	Për procedurat e regjistrimit, të organizimit dhe klasifikimit të veprave të të drejtave të autorit.....	249
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 35, datë 18.1.2017	Për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe të shpërblimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA).....	251
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 36, datë 18.1.2017	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës së transmetimit 110 kV Laç-Skuraj.....	253
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 37, datë 18.1.2017	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 110/20 kV Gjiri i Lalëzit, Durrës.....	254
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 38, datë 18.1.2017	Për miratimin e rregullave të ndërveprueshmërisë të të dhënave, grupeve të të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore.....	255
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 223, datë 13.1.2017	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i Qendrës së Qytetit Koplik”.....	285

**VENDIM****Nr. 20, datë 18.1.2017**

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE
FINANCIARE TË PERSONELIT TË
SHËRBIMIT TË JASHTËM DHE
FAMILJARËVE QË I SHOQËROJNË ATA
GJATË KOHËS QË DËRGOHEN ME
SHËRBIM NË MISIONET DIPLOMATIKE
DHE POSTET KONSULLORE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
JASHTË VENDIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 50, 53, 54 e 55, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 126, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për efekt të këtij vendimi, personel i shërbimit të jashtëm, janë:

a) personeli diplomatik në misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja;

b) personeli administrativo-teknik në misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja, pa përfshirë personelin teknik vendas, të emëruar sipas parashikimeve të nenit 33, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”.

2. Për efekt të këtij vendimi, familjarë të personelit të shërbimit të jashtëm janë bashkëshorti/ja, fëmijët nën moshën 18 vjeç, si dhe persona të tretë, në kujdestari të personelit të shërbimit të jashtëm, që e shoqërojnë personelin në detyrë.

3. Ministria e Punëve të Jashtme përballon shpenzimet për sigurimin e jetës së personelit të shërbimit të jashtëm dhe të familjarëve të tyre në rastet kur vendi pritës konsiderohet vend me rrezikshmëri të lartë. Sigurimi i jetës do të paguhet për sa kohë vazhdon situata e rrezikshmërisë së lartë. Në rastet kur familjarët nuk e shoqërojnë personelin e shërbimit të jashtëm në vendin pritës, ata nuk e përfitojnë sigurimin e jetës. Rrezikshmëri e lartë, për efekt sigurimi sipas këtij vendimi, konsiderohen situatat kur:

a) në shtetin pritës shpallet gjendja e luftës ose e jashtëzakonshme;

b) në shtetin pritës mbizotërojnë situata të përkeqësuar të sigurisë dhe të rendit publik, të cilat vlerësohen të rrezikshme për jetën.

Procedurat e përzgjedhjes së kompanive të sigurimit dhe prokurimi i fondeve për sigurimin e jetës kryhen nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe i nënshtrohen legjislacionit në fuqi.

4. Ministria e Punëve të Jashtme mbulon shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të bashkëshortit/es të personelit të shërbimit të jashtëm për periudhën që ai e shoqëron personelin në shërbim. Masa e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për bashkëshortin/en e personelit të shërbimit të jashtëm të llogaritet, përkatësisht, si më poshtë vijon:

a) Për bashkëshortin/en, i cili/e cila, përpara emërimit të personelit të shërbimit të jashtëm me detyrë jashtë vendit ka qenë në marrëdhënie pune, e barasvlershme me masën që është paguar në momentin e shkëputjes së marrëdhënieve të punës;

b) Për bashkëshortin/en, i cili/e cila nuk ka qenë në marrëdhënie pune, në masën e pagës minimale të sigurueshme në Republikën e Shqipërisë;

c) Në rast se bashkëshorti/ja punësohet me kohë të pjesshme në misionet diplomatike ose konsullore të Republikës së Shqipërisë, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paguhet nga MPJ-ja, në përputhje me parashikimet e shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike;

ç) PAGESA e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për bashkëshortët e personelit të shërbimit të jashtëm i nënshtrohet rishikimit, në të njëjtën formë siç rishikohet pagesa e kontributit për sigurimet shoqërore e shëndetësore të detyrueshme në Republikën e Shqipërisë;

d) Në rastet kur bashkëshorti/ja nuk e shoqëron personelin e shërbimit të jashtëm në detyrë, ai nuk përfiton sigurimin shoqëror dhe shëndetësor të parashikuar në këtë pikë.

5. Personeli i shërbimit të jashtëm dhe familjarët e tyre kanë të drejtë që, për raste urgjencash të jashtëzakonshme, të cilat vënë në rrezik shëndetin e tyre, me miratim të titullarit të misionit ose postit, të mjekohen në vendin pritës, kur një shërbim i tillë nuk është parashikuar në kontratën e sigurimit



shëndetësor. Në këtë rast, shpenzimet përballohen nga buxheti i misionit diplomatik ose postit konsullor.

6. Bashkëshorti/ja i personelit të shërbimit të jashtëm përfiton shpërblim mujor në vlerën 50 për qind të pagës së pozicionit të punës, grada “Atashe”, të vendit të emërimit të personelit të shërbimit të jashtëm. Pagesa e shpërblimit mujor fillon pas paraqitjes nga titullari i misionit diplomatik ose postit konsullor në MPJ të vërtetimit të shoqërimit të personelit të shërbimit të jashtëm nga bashkëshorti/ja në detyrë, në vendin pritës.

Ky shpërblim i nënshtrohet ndalesave të tatimit mbi të ardhurat, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Shpërblimi derdhet në llogarinë e bashkëshortit/es, në një nga bankat e vendit pritës, ku bashkëshorti/ja ka llogarinë personale.

Në rast se bashkëshorti/ja emërohet në një nga pozicionet e stafit teknik në mision/post konsullor, humbet të drejtën e përfitimit të shpërblimit mujor.

Bashkëshorti/ja i personelit të shërbimit të jashtëm, cili/e cila nuk e shoqëron atë në detyrë në vendin pritës, nuk përfiton shpërblimin e parashikuar në këtë pikë. I ndërpritet e drejta për shpërblim mujor bashkëshortit/es, i cili/e cila nuk shoqëron personelin e shërbimit të jashtëm për më shumë se tre muaj rresht në detyrë.

7. Çdo fëmijë nën moshën 18 vjeç, që jeton me personelin e shërbimit të jashtëm në vendin pritës, përfiton shpërblim mujor me vlerën 20 për qind të pagës së gradës “Atashe”, të vendit të emërimit të personelit të shërbimit të jashtëm. Ky shpërblim i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Shpërblimi i fëmijës derdhet në llogarinë e personelit të shërbimit të jashtëm.

8. Në rastet kur në vendin pritës shkollat publike janë me pagesë, shpenzimet e shkollimit të fëmijëve të personelit të shërbimit të jashtëm përballohen nga buxheti i misionit diplomatik ose postit konsullor përkatës deri në përfundimin e arsimit të mesëm. Pagesa kryhet me miratimin e MPJ-së, pas paraqitjes nga titullari i misionit/postit konsullor të dokumentacionit, si më poshtë vijon:

a) Vërtetim, nga autoritetet e vendit pritës, që shkollat publike në këtë vend janë me pagesë;

b) Vërtetim të masës së pagesës mujore/vjetore që duhet të paguhet për shkollimin e fëmijës, të

lëshuar nga institucioni arsimor publik i vendit pritës ku do të studiojë fëmija.

9. Në rastet kur në shtetin pritës gjuha e shkollimit në shkollat publike nuk është anglishtja, frëngjishtja, italishtja, gjermanishtja, spanjishtja, shkollimi i fëmijëve të personelit të shërbimit të jashtëm mund të bëhet në shkolla private të licencuara. Në këto raste, me miratimin e ministrit të Punëve të Jashtme, mund të mbulohet tarifa për shkollimin e fëmijëve deri në masën 2 500 (dy mijë e pesëqind) euro në vit. Mbulimi i këtyre shpenzimeve bëhet nga buxheti i misionit diplomatik ose postit konsullor përkatës. Shpenzimet e tjera të shkollimit, si: pagesa e librave, transporti, pjesëmarrja në aktivitete kulturore, sportive etj. përballohen nga personeli i misionit ose postit konsullor.

10. Gjatë ushtrimit të detyrës në misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, përveç pagës së përcaktuar me ligj, personeli i shërbimit të jashtëm dhe familjarët që e shoqërojnë gjatë shërbimit përfitojnë trajtim financiar të posaçëm, si më poshtë vijon:

a) Ministria e Punëve të Jashtme mbulon shpenzimet e transportit të personelit të shërbimit të jashtëm dhe familjarëve të tyre nga Shqipëria në misionin diplomatik ose postin konsullor, në kohën e emërimit, si dhe shpenzimet e transportit nga vendi i emërimit për në Shqipëri, kur ata mbarojnë detyrën;

b) Ministria e Punëve të Jashtme mbulon shpenzimet e transportit të sendeve personale të personelit, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, në momentin e emërimit dhe kthimit në atdhe. Transporti i sendeve dhe orendive personale të personelit të misionit diplomatik ose postit konsullor bëhet me miratimin e MPJ-së, deri në masën 7,5 m³ për anëtar familjeje, pa kaluar limitin e 30 m³ për çdo familje. Prokurimi i fondeve për mbulimin e këtyre shpenzimeve i nënshtrohet legjislacionit në fuqi;

c) Gjatë kohës së ushtrimit të detyrës në misionet diplomatike dhe postet konsullore jashtë vendit, personeli i shërbimit të jashtëm, përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përfitojnë të drejtën e mbulimit të shpenzimeve të qirasë së banesës, energjisë elektrike, ujit, gazit dhe ngrohjes. Fondet dhe masa e mbulimit të këtyre shpenzimeve përcaktohen nga MPJ-ja, në përputhje me parashikimet e ligjit për menaxhimin e sistemit



buxhetor dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;

ç) Ministria e Punëve të Jashtme përcakton, periodikisht, kushtet kryesore të qiramarrjes, listën e orendive të nevojshme për ambientin e banimit dhe limitet e qirapagesave për banesat e punonjësve të përfaqësive, në përputhje me tregun e pasurive të paluajtshme në vendin pritës dhe nevojat për prezantim. Rregullat e përcaktuara në këtë paragraf do të zbatohen vetëm për kontratat e qiramarrjes, të lidhura pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

d) Kur punonjësi i shërbimit të jashtëm, i emëruar në misionin diplomatik ose postin konsullor transferohet në atdhe, përfiton një shpërbtim nga Ministria e Punëve të Jashtme, në masën 50 për qind të pagës referuese, sipas postit të emërimit në mision ose post.

11. Për përmbushjen e duhur të detyrimeve protokollare në prezantim për kreun e misionit ose të postit, Ministria e Punëve të Jashtme pajis me orenditë e nevojshme ambientin e tij të banimit, që shërben si rezidencë. Këto pajisje përfshihen në inventarin e përfaqësisë.

12. Në rastet kur misioni diplomatik ose posti konsullor ka në gjendje pajisje, automjete, inventar ekonomik dhe materiale të ndryshme, përdorimi i të cilave është pa efektivitet ose i panevojshëm, me miratim të nëpunësit të autorizuar të institucionit ose punonjësit të autorizuar prej tij, ato mund të shiten, të kthehen në atdhe, të kalohen në një mision tjetër diplomatik ose post konsullor, apo të dalin jashtë përdorimit, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë menaxhimin e aktivëve në sektorin publik.

Të ardhurat e përfituara derdhen në llogarinë e misionit diplomatik ose postit konsullor, duke vënë menjëherë në dijeni Ministrinë e Punëve të Jashtme, e cila vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi.

13. Të ardhurat në valutë, që sigurohen nga shërbimi konsullor në misionet diplomatike ose postet konsullore jashtë vendit, përdoren si likuiditete, në zbatim të planit të buxhetit të misionit diplomatik ose postit konsullor, duke pakësuar, për të njëjtën shumë, transferimin e fondeve të misionit diplomatik ose postit konsullor nga Ministria e Punëve të Jashtme.

14. Me miratimin e ministrit të Punëve të Jashtme, për raste fatkeqësish (vdekja e prindërve, bashkëshortit/es, fëmijës, vëllait dhe motrës), për

anëtarin e personelit të shërbimit të jashtëm dhe bashkëshortin/en, nga Ministria e Punëve të Jashtme mund të mbulohen vetëm shpenzimet e udhëtimit për kthimin në atdhe dhe rikthimin në shtetin ku është misioni diplomatik ose posti konsullor.

15. Në rastet e paafësisë së përkohshme në punë të personelit të shërbimit të jashtëm, pagesa e tij bëhet sipas legjislacionit në fuqi, nga fondet e misionit ose postit konsullor përkatës.

16. Në rast humbjeje të jetës së anëtarit të personelit të shërbimit të jashtëm apo të pjesëtarit të familjes që e shoqëron në detyrë, shpenzimet për transportin e trupit në atdhe, si dhe ato të ceremonisë mortore përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme.

17. Në rastet e një barrë lindjeje të diplomates gjatë kohës që është në detyrë në një mision diplomatik ose post konsullor, për periudhën 63 ditë nga lindja e fëmijës, ajo paguhet me pagë të plotë. Diplomata njofton titullarin e përfaqësisë dy muaj përpara përfitimit të lejes së barrë lindjes.

Gjatë kohës së përfitimit të së drejtës së barrë lindjes, pas kalimit të periudhës 63-ditore nga lindja e fëmijës, pagesa e barrë lindjes mbulohet nga sigurimet shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Në rast se diplomata vendos të vijojë lejen e barrë lindjes pas periudhës 63-ditore, nga lindja e fëmijës, diplomata dhe familjarët e saj humbasin të gjitha të drejtat e trajtimit financiar në vendin pritës, të parashikuara në këtë vendim.

18. Vendimi nr. 673, datë 11.9.2003, i Këshillit të Ministrave, “Për të drejtat e punonjësve të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja”, vendimi nr. 865, datë 18.6.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të kushteve dhe të mënyrës së financimit për arsimin e detyrueshëm dhe të mesëm, të fëmijëve të personelit të emëruar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja”, dhe çdo dispozitë tjetër, që bie ndesh me këtë vendim, shfuqizohen.

19. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2017.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 21, datë 18.1.2017

PËR SIGURIMIN SHËNDETËSOR TË
VEÇANTË TË PUNONJËSVE TË DISA
STRUKTURAVE TË POLICISË SË
SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 68, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit e strukturave të veçanta të Policisë së Shtetit, në funksion të përmbushjes së detyrës së tyre, përfitojnë sigurim shëndetësor të veçantë për shërbime shëndetësore, të cilat nuk janë pjesë të paketave të shërbimit shëndetësor, që ofrohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

2. Kategoritë e punonjësve të Policisë së Shtetit, që përfitojnë sigurimin shëndetësor të veçantë, janë si më poshtë:

- a) forcat speciale;
- b) forcat operationale të ndërhyrjes së shpejtë;
- c) forcat e posaçme operationale;
- ç) punonjësit e policisë që shërbejnë si oficerë kontakti, pranë ministrive homologe të shteteve të huaja, të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë.

3. Punonjësit e policisë, të përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, përfitojnë nga sigurimi shëndetësor i veçantë, shërbim shëndetësor:

- a) për kontrollin parandalues;
- b) diagnostikues;
- c) kurues.

4. Policia e Shtetit, për shërbimet shëndetësore, të cilat nuk janë pjesë e paketave të shërbimit shëndetësor, që ofrohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, lidh kontratë me shoqërinë e sigurimit, të përzgjedhur sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

5. Policia e Shtetit, me qëllim ofrimin e shërbimit shëndetësor të veçantë, kryen procedurat si më poshtë vijon:

a) brenda muajit korrik të çdo viti, parashikon fondet buxhetore, duke përlogaritur një prim sigurimi jo më shumë se 18 000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë për çdo punonjës që do të sigurohet;

b) brenda muajit dhjetor të çdo viti, harton listën e punonjësve përfitues, sipas përcaktimeve të pikës 2, të këtij vendimi;

c) përzgjedh shoqërinë e sigurimit sipas rregullave të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik;

ç) njësitë buxhetore i dërgojnë shoqërisë së sigurimit, brenda dy ditëve, çdo ndryshim që ndodh në listën emërore të përfituesve.

6. Fondi i përcaktuar për këtë qëllim, planifikohet për çdo vit në programin buxhetor të Policisë së Shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 22, datë 18.1.2017

PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2017, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E PUNËVE TË
BRENDSHME, NGA FONDI REZERVË
I BUXHETIT TË SHTETIT, PËR
SHLYERJEN E DETYRIMEVE
QË RRJEDHIN NGA ZBATIMI
I VENDIMEVE GJYQËSORE
PËR VIKTIMAT E NGJARJES SË
21 JANARIT 2011

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve të Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2017, i shtohet fondi prej 160 011 479 (njëqind e gjashtëdhjetë milionë e njëmbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekësh, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore për viktimat e ngjarjes së 21 janarit 2011, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, akordohet për Gardën e Republikës së Shqipërisë, për shlyerjen e detyrimeve sipas vendimeve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Lidhja nr. 1

Vendimi	Gjykata	Vlera e detyrimit
Vendimi nr. 2716, datë 28.7.2016	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, i formës së prerë	42 021 626 lekë
Vendimi nr. 6189, datë 21.12.2016	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, i formës së prerë	23 619 896 lekë
Vendimi nr. 6337, datë 28.12.2016	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, i formës së prerë	18 836 416 lekë
Vendimi nr. 6300, datë 27.12.2016	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, i formës së prerë	75 533 541 lekë
		Totali 160 011 479 lekë

VENDIM

Nr. 26, datë 18.1.2017

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT NR. 2
TË MARRËVESHJES SË GRANTIT
NR.TF013972, NDËRMJET SHQIPËRISË
DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE
PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM/SHOQATËS
NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM,
QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E
FONDEVE GRANT, TË SIGURUARA NGA
DHURUES TË NDRYSHËM, NËN
FONDIN E DYTË TË BESIMIT
SHUMËDHURUES PËR SHQIPËRINË,
PËR MBËSHTETJEN PËR NGRITJEN
E KAPACITETEVE PËR ZBATIMIN
E SISTEMIT TË PLANIFIKIMIT TË
INTEGRUAR (SPI) 2**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për

marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit nr. 2 të marrëveshjes së grantit nr. TF013972, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve grant të siguruar nga dhurues të ndryshëm, nën fondin e dytë të besimit shumëdhurues për Shqipërinë, për mbështetjen për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e sistemit të planifikimit të integruar (SPI) 2, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi



Banka Botërore
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
SHOQATA PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR

1818 H Street N.W.
Washington, D.C. 20433
U.S.A.

(202) 477-1234
Adresa kablllore: INTBAFRAD
Adresa kablllore: INDEVA

24 gusht 2016

Shkëlqesisë së Tij, Arben Ahmetaj
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë, Republika e Shqipërisë

Lënda: Mbështetje për ngritjen e kapaciteteve shqiptare për Zbatimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI)2

Granti nr. TF013972

Ndryshimi nr. 2 i Marrëveshjes së Grantit

Shkëlqesi,

Ne i referohemi marrëveshjes së grantit, të datës 7 mars 2013 si (Marrëveshje), e ndryshuar, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar (Banka Botërore), në datën 7 mars 2013, e ndryshuar, për Fondin e Besimit me Shumë Donatorë për Mbështetje për Ngritjen e Kapaciteteve Shqiptare për Zbatimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI)2 (Projekti) dhe letrës suaj, të datës 2 nëntor 2015, ku i kërkon Bankës Botërore të shtyjë Datën e Mbylljes për Grantin e cituar më sipër sipas Marrëveshjes.

Në lidhje me sa më sipër dhe diskutimet tona më të fundit, Banka Botërore propozon të amendojë Marrëveshjen për të shtyrë Datën e Mbylljes dhe të përditësojë politikën e zbatueshme të prokurimit.

Në përputhje me këtë, Marrëveshja amendohet si vijon:

1. Paragrafët “i” dhe “ii” të seksionit 2.07(a) të Marrëveshjes janë amenduar këtu dhe janë zëvendësuar tërësisht, duke u lexuar si vijon:

“i) Seksioni I i “Udhëzime: Prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve jo-të konsulencës sipas kredive IBRD dhe krediteve IDA dhe granteve nga Huamarrësit e Bankës Botërore”, i muajit janar 2011 (e rishikuar në korrik 2014) (“Udhëzime për prokurimet”), në rastin e mallrave dhe të shërbimeve jokonsulente;

ii) Seksionet I dhe IV të “Udhëzime: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve sipas kredive IBRD dhe krediteve IDA dhe granteve nga Huamarrësit e Bankës Botërore”, të muajit janar 2011 (e rishikuar në korrik 2014) (“Udhëzime për konsulentët”), në rastin e shërbimeve të konsulentëve; dhe”

2. Seksioni 3.03 i Marrëveshjes është amenduar këtu dhe është zëvendësuar tërësisht, duke u lexuar si vijon:

“3.03. **Periudha e tërheqjes.** Data e mbylljes, e referuar në seksionin 3.06 (c) të kushteve standarde është 30 qershor 2018.”

Të gjitha afatet dhe kushtet e tjera të Marrëveshjes, me përjashtim sa është amenduar këtu, mbeten në fuqi dhe efekt të plotë.

Ju lutem, konfirmoni pranimin tuaj në lidhje me amendamentin e mësipërm, duke e nënshkruar dhe vendosur datën në këtë letër, në hapësirën e dhënë më poshtë. Kjo letër amendamenti do të realizohet në dy kopje të njëjta, ku secila prej tyre do të jetë origjinale dhe njëra prej tyre do të kthehet te ne. Dispozitat e vendosura në këtë letër amendamenti do të hyjnë në fuqi në datën e njoftimit nga Marrësi për Bankën Botërore në lidhje me përfundimin e procedurave të saj të brendshme.

Ju lutem vini re, gjithashtu se, shkresa rristrukturuese e datës 31 mars 2016, një kopje e së cilës është bashkëlidhur këtu, do të jepet në faqen zyrtare të jashtme të Bankës sipas politikës së Bankës mbi aksesin në informacion.



Me respekt,
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
SHOQATA PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR

Nga *(nënshkrimi)*

Ellen Goldstein

Drejtores e Vendlit

Njësia e Vendeve të Europës Juglindore

PRANUAR:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Data: _____

Bashkëlidhur

Nënshkruani këtu

VENDIM

Nr. 30, datë 18.1.2017

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
SHITESË TË KONCESIONIT “PËR DISA
NDRYSHIME DHE SHITESA NË
MARRËVESHJEN E KONCESIONIT
LIDHUR ME PROJEKTIMIN,
FINANCIMIN, NDËRTIMIN,
PRONËSINË, OPERIMIN,
MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN
E NJË PROJEKTI PËR NJË
HIDROCENTRAL TË RI NË ASHTË,
REPUBLIKA E SHQIPËRISË, NDËRMJET
MINISTRISË SË ENERGJISË DHE
INDUSTRIË (AUTORITETI
KONTRAKTUES) DHE VERBUND AG
(KONCESIONARI) DHE ENERGJI ASHTA
SHPK (SHOQËRIA E PROJEKTTIT)”,
MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 1363,
DATË 17.10.2008, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 50, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes shtesë të koncesionit “Për disa ndryshime dhe shtesa në marrëveshjen e koncesionit lidhur me projektimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e një projekti për një hidrocentral të ri në Ashtë, Republika e Shqipërisë, ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë

(Autoriteti Kontraktues) dhe VERBUND AG (Koncesionari) dhe Energji Ashta sh.p.k. (Shoqëria e projektit)”, miratuar me vendimin nr. 1363, datë 17.10.2008, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

PROJEKTMARRËVESHJE

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA TË
MARRËVESHJË E KONCESIONIT NË
LIDHJE ME PROJEKTIMIN, FINANCIMIN,
NDËRTIMIN, PRONËSINË, OPERIMIN,
MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E
NJË PROJEKTI PËR NJË HIDROCENTRAL
TË RI NË ASHTË, REPUBLIKA E
SHQIPËRISË NDËRMJET MINISTRISË SË
ENERGJISË DHE INDUSTRIË DHE
VERBUND AG (I REFERUAR MË PARË SI
ÖSTERREICHISCHE
ELEKTRIZITÄTSWIRTSCHAFTS
AKTIENGESELLSCHAFT)
(KONCESIONARI) DHE ENERGJI ASHTA
SHPK (SHOQËRIA E PROJEKTTIT)
[.], 2016

Kjo Marrëveshje (në vijim e referuar si “Marrëveshja”) lidhet në Tiranë, Shqipëri, sot më [.] 2016, nga dhe ndërmjet:

1. Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë të Republikës së Shqipërisë, e cila vepron si ministria e linjës për sektorin e energjisë në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 883, datë



18.9.2013 “Mbi përcaktimin e qëllimit të përgjegjësisë të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë”, të ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 840, datë 27.9.2013 (“Autoriteti Kontraktues”); dhe

2. Verbund AG (më parë i emërtuar Österreichische Elektrizitätswirtschafts Aktiengesellschaft), një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit austriak, e regjistruar pranë regjistratit të shoqërive pranë Gjykatës Tregtare të Vjenës, me numër regjistrimi FN 76023z, me seli në Vjenë dhe adresë biznesi në: Am Hof 6A, 1011 Vjenë, Austri (“Koncesionari”); dhe

3. Energji Ashta sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila vepron në përputhje me ligjet e Shqipërisë, me seli ligjore pranë Hidrocentralit të Ashtës, në fshatin Spatharë, Bushat, Bashkia e Vaut të Dejës, rrethi Shkodër, Shqipëri, e regjistruar pranë Regjistratit Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër unik identifikimi NIPT – K82417005V, (“Shoqëria e Projektit”);

Autoriteti Kontraktues, Koncesionari dhe Shoqëria e Projektit do të referohen, gjithashtu, veçmas si “Palë” dhe bashkërisht si “Palët”.

HYRJE

Duke pasur parasysh që:

A. Më 30.9.2008, pas zhvillimit të procedurave ndërkombëtare të tenderimit, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë (aktualisht e referuar si “Ministria e Energjisë dhe Industrisë”) dhe Koncesionari lidhën marrëveshjen e koncesionit lidhur me projektimin, financimin, ndërtimin, zotërimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e hidrocentralit të ri në Ashtë, Republika e Shqipërisë (“Marrëveshja e Koncesionit”);

B. Në të njëjtën datë, Koncesionari dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. (“KESH”) lidhën: i) Marrëveshjen për shitjen e energjisë elektrike të gjeneruar nga hidrocentrali i Ashtës (“Marrëveshja për Shitjen e Energjisë”); dhe ii) Marrëveshjen e Koordinimit të Kaskadës së lumit Drin (“Marrëveshja për Koordinimin e Kaskadës”), veçanërisht në lidhje me koordinimin e operimit dhe administrimit të kaskadës së lumit Drin në të cilën ndodhen hidrocentralet e operuara nga KESH-i, dhe Hidrocentrali i Ashtës (së bashku me Marrëveshjen e Koncesionit, Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë dhe Marrëveshjen për

Koordinimin e Kaskadës, të referuara së bashku në vijim si “Marrëveshjet e Projektit”);

C. Më 9.2.2009, Koncesionari njoftoi Autoritetin Kontraktues për kalimin të Shoqëria e Projektit të të drejtave dhe detyrimeve sipas Marrëveshjes së Koncesionit me të cilën Koncesionari mbetet personalisht dhe bashkërisht përgjegjës;

D. Më 31.3.2010, Koncesionari njoftoi KESH-in për kalimin të Shoqëria e Projektit të të drejtave dhe detyrimeve të Koncesionarit sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë dhe Marrëveshjes për Koordinimin e Kaskadës;

E. Si rrjedhojë e ndryshimeve në sektorin shqiptar të energjisë elektrike, Autoriteti Kontraktues i ka kërkuar Shoqërisë së Projektit si Shitës të lejojë transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të Blerësit sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë, nga KESH-i, të shoqëria me kapital shtetëror, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (në vijim i referuar si “OSHEE”), e cila vepron aktualisht si Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në Shqipëri;

F. Shoqëria e Projektit, KESH-i dhe OSHEE-ja kanë arritur një marrëveshje për kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të Blerësit sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë Elektrike nga KESH-i tek OSHEE-ja; Marrëveshja për Kalimin e Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë Elektrike e arritur ndërmjet Shoqërisë së Projektit, KESH-it dhe OSHEE-së është bashkëlidhur këtu si pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

G. Marrëveshja për Shitjen e Energjisë është pjesë përbërëse e Marrëveshjes së Koncesionit, e cila përmban disa parashikime me referenca krahasuese në rastin e mospërmblotjes nga ana e Blerësit, në përputhje me Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë; pra, transferimi i sugjeruar i të drejtave dhe detyrimeve të Blerësit sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë nga KESH-i tek OSHEE-ja kërkon kryerjen e disa ndryshimeve të Marrëveshja e Koncesionit; si dhe

H. Autoriteti Kontraktues, Koncesionari dhe Shoqëria e Projektit si Shitës, kanë biseduar e rënë dakord mbi disa ndryshime dhe shtesa të Marrëveshja e Koncesionit, ndryshime të cilat janë të nevojshme si rrjedhojë e kalimit të propozuar të të drejtave dhe detyrimeve të Blerësit, në përputhje me Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë, nga KESH-i tek OSHEE-ja;



Si rrjedhojë, duke pasur parasysh angazhimet e parashikuara këtu, mjaftueshmëria e të cilave është pranuar, Palët bien dakord si më poshtë:

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIMI

1.1 Përkufizime

Shprehjet e përkufizuara në pjesë të tjera në Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë do të përdoren dhe këtu me të njëjtin kuptim që u është dhënë në Marrëveshjen e Koncesionit, me përjashtim nëse janë përkufizuar ndryshe në këtë Marrëveshje dhe kur kërkohet ndryshe nga konteksti i saj.

1.2 Interpretimi

Kjo Marrëveshje interpretohet në përputhje me dispozitat interpretuese të Marrëveshjes së Koncesionit, me përjashtim kur kërkohet ndryshe nga konteksti i saj.

2. HYRJA NË FUQI

Kjo Marrëveshje do të hyjë plotësisht në fuqi në datën më të vonshme midis periudhës së: i) plotësimit nga OSHEE-ja të Garancisë Bankare të Blerësit sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë; ii) miratimit të kësaj Marrëveshjeje nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (“Hyrja në fuqi”).

3. NDRYSHIMET TE MARRËVESHJA E KONCESIONIT

3.1 Ndryshimet te neni 1.1

Neni 1.1 i Marrëveshjes së Koncesionit ndryshohet si vijon:

3.1.1 Përkufizim i termit “Autoritet Kontraktues” ndryshohet si më poshtë: “Autoritet Kontraktues” nënkupton ministrinë e linjës të qeverisë së Republikës së Shqipërisë, përgjegjëse për energjinë, aktualisht e referuar si “Ministria e Energjisë dhe Industrisë”.

3.1.2 Pas përkufizimit të termit “Faza operacionale” shtohet termi i përkufizuar si vijon: “OSHEE” nënkupton Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., operator i shpërndarjes së energjisë me kapital shtetëror shqiptar dhe furnizues publik i shitjes me pakicë, si dhe pasuesve dhe drejtëmarrësve të tij.

3.1.3 Përkufizimi i termit “Marrëveshje për Shitjen e Aksioneve” ndryshohet si vijon: “Marrëveshje për Shitjen e Aksioneve” nënkupton marrëveshjen merr ose paguaj, të lidhur në datën 30.9.2008, nga Koncesionari si Shitës dhe KESH-i si Blerës, në zbatim të tekstit të bashkëlidhur si shtojca A (Marrëveshja për Shitjen e Energjisë) të

Marrëveshjes së Koncesionit, e cila iu delegua më vonë Shoqërisë së Projektit si Shitës dhe OSHEE-së si Blerës, në përputhje me kushtet dhe afatet e detyrave përkatëse.

3.1.4 Termi “Blerës” ndryshohet si vijon: “Blerës” nënkupton OSHEE-në.

3.2 Zëvendësimi i termave

3.2.1 Çdo referim të “METE” në Kontratën e Koncesionit zëvendësohet me termin “Autoritet Kontraktues”.

3.2.2 Në nenet 2.1(v), 4.1, 11.2.5(b), 11.2.5(c), 11.2.5(d), 11.3(a)(v)(x) dhe (y) të Marrëveshjes së Koncesionit, termi “KESH” zëvendësohet nga termi “OSHEE”.

4. SHITESAT TE KONTRATA E KONCESIONIT

4.1 Deklarimet dhe përfaqësimet nga Autoriteti Kontraktues

Në nenin 2.3 të Marrëveshjes së Koncesionit, pas paragrafit “c” shtohet një paragraf i ri “d” si vijon:

d) Nëse në çfarëdo momenti gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë, e drejta: i) për të zgjedhur shumicën në këshillin drejtues (ose çdo organ tjetër drejtues) të OSHEE-së; ose ii) për të udhëhequr ndryshe administrimin dhe politikën e saj, transferohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një palë e tretë, e cila nuk është Entitet Shtetëror, atëherë, me kërkesën e shkruar të Koncesionarit, Autoriteti Kontraktues do të sigurojë që Marrëveshja për Shitjen e Energjisë t’i kalohet pa vonesa një entiteti apo shoqërie tjetër publike, të kontrolluar nga një Entitet Shtetëror, që të ketë një kredibilitet financiar të paktën të barasvlershëm me atë të OSHEE-së, në datën e kësaj Marrëveshjeje, me detyrimin për këtë entitet apo shoqëri tjetër publike për të përmbushur me përpikëri detyrimet e Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë. Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të bëjnë, gjithashtu, ndryshimet e nevojshme në këtë Marrëveshje, për të reflektuar kalimin e Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë.

5. TË NDRYSHME

5.1 Marrëveshja e plotë

Kjo Marrëveshje, duke përfshirë dhe hyrjen e saj, përfaqëson të gjithë marrëveshjen ndërmjet Palëve në lidhje me qëllimin e saj dhe i mbivendoset cilësdo dhe të gjitha marrëveshjeve apo masave të mëparshme ndërmjet të njëjtave Palë, pavarësisht nëse kanë qenë në formë verbale



apo të shkruar, në lidhje me të njëjtin qëllim. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një instrumenti me shkrim të nënshkruar sipas rregullave nga Palët.

Kushtet dhe parashikimet e Marrëveshjes së Koncesionit do të mbeten të pandryshuara, me përjashtim të sa parashikohet shprehimisht këtu.

5.2 Përfaqësimet dhe Autoriteti Korporativ

EA i përfaqëson dhe i garanton Autoritetit Kontraktues se janë marrë të gjitha miratimet e nevojshme paraprake korporatave dhe aksionare në lidhje me këtë Marrëveshje dhe se nënshkruesit përkatës kanë autoritetin e duhur korporativ për të lidhur këtë Marrëveshje.

5.3 Interpretimi i Marrëveshjes në tërësi

Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje konsiderohet e pavlefshme ose e pazbatueshme nga ndonjë autoritet gjyqësor apo autoritet tjetër kompetent, të gjitha dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje do të mbeten plotësisht në fuqi dhe nuk do të ndikohen në asnjë mënyrë.

5.4 Gjuha

Kjo Marrëveshje do të nënshkruhet dhe zbatohet në gjuhën angleze. Palët do të bien dakord mbi një përkthim të saj në gjuhën shqipe sa më parë të jetë e mundur pas nënshkrimit të versionit në gjuhën angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi ndaj versionit në gjuhën shqipe.

5.5 Mosheqja dorë

Nuk do të konsiderohet se është hequr dorë nga asnjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje prej cilësdo Palë, me përjashtim kur kjo heqje dorë është kryer shprehimisht me shkrim. Mosinsistimi nga cilado prej Palëve për zbatimin rigoroz të cilësdo prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje apo përfitimi nga ndonjë prej të drejtave të saj sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga cilado prej këtyre dispozitave apo heqje dorë nga ndonjëra prej të drejtave në të ardhmen.

Lidhja e kësaj Marrëveshjeje nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga ajo dhe nuk ndikon tek asnjë prej të drejtave dhe/ose pretendimeve që Palët mund të kenë, të cilat lindin nga ose në lidhje me Marrëveshjet e Projektit, nëse nuk parashikohet shprehimisht ndryshe këtu.

5.6 Ligji rregullues

Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

5.7 Mosmarrëveshjet

Çdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me Marrëveshjen do të zgjidhet në përputhje me procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të parashikuara në Marrëveshjen e Koncesionit.

Në dëshmi të kësaj, kjo Marrëveshje nënshkruhet në 4 (katër) ekzemplarë origjinalë nga përfaqësuesit e autorizuar rregullisht të Palëve, në datën e parë të shkruar më sipër.

[nënshkrimet vijnë në faqen tjetër]

MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIË E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

VERBUND AG

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

ENERGJI ASHTA sh.p.k.

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

PROJEKTMARRËVESHJE
PËR KALIMIN E MARRËVESHJES SË
SHITJES SË ENERGJISË NË LIDHJE ME NJË
PROJEKT TË RI HIDROCENTRALI NË
ASHTË, REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NDËRMJET KORPORATËS
ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE SHA
ENERGJI ASHTA SHPK. DHE OPERATORIT
TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE SHA

[.] 2016

Kjo Marrëveshje (në vijim e referuar si “Marrëveshja”) lidhet në Tiranë në datën [.] 2016 nga dhe ndërmjet:

1. Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. një shoqëri aksionare e themeluar dhe që vepron në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, me seli ligjore pranë bllokut “Vasil Shanto”, Tiranë, Shqipëri, e regjistruar pranë Regjistrat Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër unik identifikimi – NIPT J 61817005F, të përfaqësuar sipas rregullave në këtë Marrëveshje nga Z. Agron Hetoja, në cilësinë e drejtorit ekzekutiv/administratorit (në vijim i referuar si “KESH” ose “Ceduesi”); dhe

2. Energji Ashta sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar që vepron në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, me seli ligjore pranë Hidrocentralit të Ashtës, në fshatin Spatharë, Bushat, Bashkia e Vaut të Dejës, Rrethi Shkodër,



Shqipëri, e regjistruar pranë Regjistrisë Tregtare, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik identifikimi NIPT – K82417005V, e përfaqësuar sipas rregullave në këtë Marrëveshje nga z. Dietmar Reiner dhe z. Peter Stelzer, në cilësinë e drejtorëve të përgjithshëm (në vijim e referuar, si: “EA”, “Shoqëria e Projektit” ose “Shitësi”); dhe

3. Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. një shoqëri aksionare e themeluar dhe që vepron në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, me seli ligjore pranë Njësisë Bashkiake nr. 5, Rruga “Andon Zako Çajupi”, pallati Conad, kati i 3, Tiranë, Shqipëri, e regjistruar pranë Regjistrisë Tregtare, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër unik identifikimi – NIPT K72410014H, e përfaqësuar sipas rregullave në këtë Marrëveshje nga z. Adrian Çela në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv/Administratorit (në vijim e referuar si “OSHEE” ose “Përfituesi”).

KESH-i, EA dhe OSHEE referohen, gjithashtu, veçmas si “Palë” dhe bashkërisht si “Palët”.

HYRJE

Duke pasur parasysh që:

A. Më 30.9.2008, pas zhvillimit të procedurave ndërkombëtare të tenderimit, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë (aktualisht e referuar si “Ministria e Energjisë dhe Industrisë”) dhe Österreichische Elektrizitätswirtschafts Aktiengesellschaft (aktualisht e titulluar “Verbund AG” – në vijim referuar si “Koncesionari”) kanë lidhur marrëveshjen e koncesionit për projektimin, financimin, ndërtimin, zotërimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e hidrocentralit të ri në Ashtë, Republika e Shqipërisë (“Marrëveshja e Koncesionit”);

B. Në të njëjtën datë, Koncesionari dhe KESH-i kanë lidhur: i) Marrëveshjen për shitjen e energjisë elektrike të gjeneruar nga Hidrocentrali i Ashtës (Marrëveshja për Shitjen e Energjisë); dhe ii) Marrëveshjen e Koordinimit të Kaskadës së Lumit Drin (Marrëveshja për Koordinimin e Kaskadës), në veçanti, në lidhje me koordinimin e operimit dhe administrimit të kaskadës së lumit Drin, në të cilën ndodhen hidrocentralet e operuara nga KESH-i dhe Hidrocentrali i Ashtës (së bashku me Marrëveshjen e Koncesionit, Marrëveshja për Shitjen e Energjisë dhe Marrëveshjen për

Koordinimin e Kaskadës, të referuara bashkërisht në vijim si “Marrëveshjet e Projektit”);

C. Më 9.2.2009, Koncesionari njoftoi Autoritetin Kontraktues për kalimin të Shoqëria e Projektit të të drejtave dhe detyrimeve të parashikuara në Marrëveshjen e Koncesionit, me të cilën Koncesionari mbetet personalisht dhe bashkërisht përgjegjës;

D. Më 31.3.2010, Koncesionari njoftoi KESH-in për kalimin të Shoqëria e Projektit të të drejtave dhe detyrimeve të Koncesionarit sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë dhe Marrëveshjes për Koordinimin e Kaskadës;

E. Nëpërmjet shkresës EA/KESH 027, njoftimi i datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë - Projekt i Hidrocentralit të Ashtës, EA njoftoi KESH-in se Marrëveshja për Shitjen e Energjisë ka hyrë në fuqi më 28.3.2013. Furnizimi me energji elektrike filloi më 1.4.2013;

F. Marrëveshja për Shitjen e Energjisë është lidhur për një periudhë pesëmbëdhjetë (15-vjeçare) nga hyrja në fuqi.

G. Si rrjedhojë e ndryshimeve në sektorin shqiptar të energjisë elektrike, Autoriteti Kontraktues i ka kërkuar EA-së transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të Blerësit sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë, nga KESH-i tek OSHEE-ja, shoqëri kjo me kapital shtetëror e cila vepron aktualisht si Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

H. EA, KESH dhe OSHEE kanë diskutuar dhe rënë dakord mbi kushtet për kalimin e marrëveshjes për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të Blerësit sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë Elektrike nga KESH-i tek OSHEE-ja;

I. Marrëveshja për Shitjen e Energjisë është pjesë përbërëse e Marrëveshjes së Koncesionit, e cila përmban disa parashikime me referenca krahasuese për rastin e mospërmblidhjes nga ana e Blerësit, në përputhje me Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë; dhe transferimi i sugjeruar i të drejtave dhe detyrimeve të Blerësit sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë, nga KESH-i tek OSHEE-ja, kërkon kryerjen e disa ndryshimeve edhe në Marrëveshjen e Koncesionit;

J. Autoriteti Kontraktues, Koncesionari dhe EA-ja kanë diskutuar dhe rënë dakord mbi ndryshimet të Marrëveshjes së Koncesionit, ndryshime të cilat janë të nevojshme si rrjedhojë e



transferimit të propozuar të të drejtave dhe detyrimeve të Blerësit sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë, nga KESH-i tek OSHEE-ja;

Si rrjedhojë, duke pasur parasysh angazhimet e parashikuara këtu, mjaftueshmëria e të cilave është pranuar, Palët bien dakord si më poshtë:

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIMI

1.1 Përkufizime

Shprehjet e përkufizuara në Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë do të përdoren këtu me të njëjtin kuptim që u është dhënë në Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë, me përjashtim nëse janë të përkufizuara ndryshe nga kjo Marrëveshje dhe kur kërkohet ndryshe nga konteksti (duke përfshirë shtojcat e saj).

1.2 Interpretime

Kjo Marrëveshje interpretohet në përputhje me dispozitat interpretuese të Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë, përjashtuar nëse kërkohet ndryshe nga konteksti.

2. HYRJA NË FUQI

Kjo Marrëveshje do të hyjë plotësisht në fuqi në datën më të vonshme midis periudhës së: i) plotësimit nga OSHEE të Garancisë Bankare të Blerësit sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë; ii) miratimit të ndryshimeve në Marrëveshjen e Koncesionit të përmendura në pikën “J” të hyrjes këtu më lart (“Hyrja në fuqi”) nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.

3. KALIMI

Pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes dhe në zbatim të kushteve dhe afateve të saj, KESH-i në cilësinë e Ceduesit, i kalon OSHEE-së në cilësinë e Pranuesit, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Blerësit sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë, dhe OSHEE si Pranues pranon këtë kalim dhe merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Blerësit (Ceduesit) sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë kundrejt EA-s si Shitës.

4. PAGESA E PRETENDIMEVE

KESH-i si Cedues dhe OSHEE-ja si Pranues, do të mbeten përgjegjës veçmas dhe bashkërisht ndaj EA-s në lidhje me çdo pretendim për pagesa të prapambetura në përputhje me Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë nga KESH-i, për periudha që i paraprijnë datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

5. NDRYSHIMET E MARRËVESHJES PËR SHITJEN E ENERGISË

5.1 Referencat te KESH-i

Që nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, çdo referencë te “KESH” në Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë do të zëvendësohet me referencat ndaj “OSHEE-së”.

5.2 Referencat te METE

Që nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, çdo referencë te “METE” në Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë do të zëvendësohet me referencat ndaj “Autoritetit Kontraktues” dhe përkufizimi përkatës i “METE-s” te neni 1.1 i Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë do të zëvendësohet me përkufizimin e mëposhtëm të termit “Autoriteti Kontraktues”:

“Autoriteti Kontraktues” nënkupton ministrinë e linjës të Republikës së Shqipërisë, përgjegjëse për sektorin e energjisë elektrike, aktualisht e emërtuar Ministria e Energjisë dhe Industrisë që vepron si Autoritet Kontraktues i Marrëveshjes së Koncesionit.

6. AFATI

Kalimi i të drejtave dhe detyrimeve sipas objektit të kësaj Marrëveshjeje kryhet për afatin e vlefshmërisë së Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë.

7. TË NDRYSHME

7.1 Marrëveshja e plotë

Kjo Marrëveshje, duke përfshirë dhe hyrjen e saj, përfaqëson të gjithë marrëveshjen ndërmjet Palëve në lidhje me qëllimin e saj dhe i mbivendoset cilëndo dhe të gjitha marrëveshjeve apo masave të mëparshme ndërmjet Palëve, në lidhje me të njëjtin qëllim, pavarësisht nëse kanë qenë në formë verbale apo të shkruar. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një instrumenti të shkruar të nënshkruar sipas rregullave nga Palët.

7.2 Përfaqësimet dhe Autoriteti Korporativ

KESH, EA dhe OSHEE përfaqësojnë dhe i garantojnë njëra-tjetrës se janë marrë të gjitha miratimet e nevojshme paraprake korporative dhe aksionare në lidhje me këtë Marrëveshje dhe se kjo Marrëveshje përmban detyrime të vlefshme dhe detyruese për Palën përkatëse, pasuesit ose drejtëmmarrësit e tyre të autorizuar. KESH, EA dhe OSHEE përfaqësojnë dhe i garantojnë njëra-tjetrës se nënshkruesit përkatës kanë autoritetin e duhur korporativ për të lidhur këtë Marrëveshje dhe për të angazhuar Palën përkatëse.

7.3 Interpretimi i Marrëveshjes në tërësi

Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje konsiderohet e pavlefshme ose e



pazbatueshme nga ndonjë autoritet gjyqësor apo autoritet tjetër kompetent, të gjitha dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje do të mbeten plotësisht në fuqi dhe nuk do të ndikohen në asnjë mënyrë.

7.4 Gjuha

Kjo Marrëveshje do të nënshkruhet dhe zbatohet në gjuhën angleze. Palët do të bien dakord mbi një përkthim të saj në gjuhën shqipe sa më pare të jetë e mundur pas nënshkrimit të versionit në gjuhën angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi ndaj versionit në gjuhën shqipe. Çdo komunikim dhe njoftim ndërmjet Palëve në lidhje me këtë do të kryhet në gjuhën angleze ose shqipe (së bashku me një përkthim në anglisht, nëse është e mundur).

7.5 Mosheqja dorë

Nuk do të konsiderohet heqje dorë nga asnjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, nga cilado Palë, me përjashtim kur kjo heqje dorë është kryer shprehimisht me shkrim. Mosinsistimi nga cilado prej Palëve për zbatimin rigoroz të cilësdo prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje apo përfitimi nga ndonjë prej të drejtave të saj sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga cilado prej këtyre dispozitave apo heqje dorë nga ndonjëra prej të drejtave në të ardhmen.

Lidhja e kësaj Marrëveshjeje nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga ajo dhe nuk ndikon mbi asnjë prej të drejtave dhe/ose pretendimeve që Palët mund të kenë, të cilat lindin nga apo në lidhje me Marrëveshjet e Projektit.

7.6 Njoftimet

Çdo njoftim ose komunikim tjetër në lidhje me këtë Marrëveshje do të kryhet në zbatim të nenit 12.7 të Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë tek adresat e mëposhtme:

Për KESH:

Korporata Elektroenergetike Shqiptare sh.a.

Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë, Shqipëri.

Në vëmendje të: Drejtorit ekzekutiv/administratorit

Tel: +355 _____

Faks: +355 _____

Për EA:

ENERGJI ASHTA sh.p.k.

Hidrocentrali i Ashtës, fshati Spatharë, Bushat, Bashkia e Vaut të Dejës, rrethi Shkodër, Shqipëri

Në vëmendje të: Drejtorit të Përgjithshëm

Tel: +355 (4) 4504236

Faks: +355 (4) 4504236

Për OSHEE:

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.

Njësia Bashkiake nr. 5, rruga “Andon Zako Çajupi”, pallati “Conad”, kati 3, Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Drejtorit ekzekutiv/administratorit

Tel: +355 _____

Fax: +355 _____

Adresat e mësipërme do të përdoren, gjithashtu, për njoftimet sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë, me përjashtim nëse njoftohet një ndryshim adrese sipas nenit 12.7 të Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë.

7.7 Ligji rregullues

Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

7.8 Mosmarrëveshjet

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje mbi ose në lidhje me Marrëveshjen (Mosmarrëveshja), secila prej Palëve do t'i dërgojë Palës tjetër një njoftim me shkrim për këtë, pas të cilit Palët do të takohen menjëherë dhe do të synojnë në mirëbesim të arrijnë një zgjidhje miqësore.

Në pamundësi të një marrëveshjeje miqësore brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit të parashikuar më lart, cilado prej Palëve mund t'ia referojë këtë Mosmarrëveshje arbitrazhit ndërkombëtar.

Të gjitha procedimet e arbitrazhit në lidhje me sa më lart do të zhvillohen dhe zgjidhen përfundimisht në Paris, Francë dhe do të kryhen në zbatim të Rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë para një komiteti prej 3 (tre) arbitrash të caktuar në përputhje me këto Rregulla.

Arbitrazhi do të zhvillohet në gjuhën angleze dhe të gjitha dokumentet e dërguara në lidhje me këto procedime do të jenë në gjuhën angleze ose të shoqëruara nga një përkthim i vërtetuar në gjuhën angleze.

Kjo Marrëveshje, si dhe Marrëveshja për Shitjen e Energjisë dhe të drejtat dhe detyrimet e Palëve do të mbeten në fuqi dhe efekt në pritje të vendimit në këtë procedim arbitrazhi, vendimi i cili, nëse është e përshtatshme, do të përcaktojë nëse dhe kur do të jetë efektive zgjidhja.

Në dëshmi sa më sipër, kjo Marrëveshje është nënshkruar nga përfaqësues të autorizuar sipas rregullave të Palëve në datën e parë të shkruar më sipër.



KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE sh.a.

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

ENERGJI ASHTA sh.p.k.

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE sh.a.

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

VENDIM**Nr. 31, datë 18.1.2017**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN
NR. 824, DATË 6.12.2006, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
INSTITUCIONEVE TË AUTORIZUARA
PËR VERIFIKIMIN, NË MËNYRË
ELEKTRONIKE, TË GJENDJES
GJYQËSORE, SI DHE TË FORMULARIT
TË VETËDEKLARIMIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 7, 8 e 11, të ligjit nr. 9614, datë 21.9.2006, “Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në kreun I, të vendimit nr. 824, datë 6.12.2006, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

1. Pas pikës 44 shtohet pika 45, me këtë përmbajtje:

“45. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi**VENDIM****Nr. 32, datë 18.1.2017**

**PËR SHPALLJEN E QENDRËS
HISTORIKE TË QYTETIT TË PËRMETIT
DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
ADMINISTRIMIN E SAJ E TË ZONËS SË
MBROJTUR PËRRETH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 4, të nenit 29, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e Qendrës Historike të qytetit të Përmetit, sipas hartës dhe koordinatave gjeografike, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e rregullores “Për administrimin e Qendrës Historike të qytetit të Përmetit dhe të zonës së mbrojtur përreth”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Ministria e Zhvillimit Urban për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi






TABELA 1

KOORDINATAT GJEOGRAFIKE TË QENDRËS HISTORIKE TË QYTETIT TË PËRMETIT

Qendra Historike		
UTM Z 34N		
Emërtimi	Long.	Lat.
P1	E20° 20' 59.678"	N40° 13' 56.481"
P2	E20° 21' 0.199"	N40° 13' 56.592"
P3	E20° 21' 0.370"	N40° 13' 56.423"
P4	E20° 21' 1.341"	N40° 13' 56.718"
P5	E20° 21' 1.523"	N40° 13' 56.850"
P6	E20° 21' 2.835"	N40° 13' 57.429"
P7	E20° 21' 3.303"	N40° 13' 57.093"
P8	E20° 21' 3.913"	N40° 13' 56.607"
P9	E20° 21' 3.688"	N40° 13' 56.328"
P10	E20° 21' 3.178"	N40° 13' 55.826"
P11	E20° 21' 4.556"	N40° 13' 54.858"
P12	E20° 21' 6.092"	N40° 13' 54.005"
P13	E20° 21' 6.579"	N40° 13' 54.152"
P14	E20° 21' 7.044"	N40° 13' 54.181"
P15	E20° 21' 8.067"	N40° 13' 53.824"
P16	E20° 21' 8.841"	N40° 13' 53.429"
P17	E20° 21' 9.855"	N40° 13' 53.216"
P18	E20° 21' 10.037"	N40° 13' 53.239"
P19	E20° 21' 10.318"	N40° 13' 54.107"
P20	E20° 21' 11.036"	N40° 13' 53.925"
P21	E20° 21' 11.592"	N40° 13' 53.705"
P22	E20° 21' 12.031"	N40° 13' 53.434"
P23	E20° 21' 12.288"	N40° 13' 53.012"
P24	E20° 21' 12.721"	N40° 13' 52.472"
P25	E20° 21' 12.201"	N40° 13' 52.180"
P26	E20° 21' 12.205"	N40° 13' 51.835"
P27	E20° 21' 12.629"	N40° 13' 51.266"
P28	E20° 21' 12.774"	N40° 13' 51.277"
P29	E20° 21' 13.094"	N40° 13' 51.436"
P30	E20° 21' 13.467"	N40° 13' 51.442"
P31	E20° 21' 14.503"	N40° 13' 51.255"
P32	E20° 21' 14.956"	N40° 13' 50.998"
P33	E20° 21' 15.108"	N40° 13' 50.884"
P34	E20° 21' 15.365"	N40° 13' 50.628"
P35	E20° 21' 15.488"	N40° 13' 50.718"
P36	E20° 21' 15.632"	N40° 13' 50.590"
P37	E20° 21' 15.372"	N40° 13' 50.372"
P38	E20° 21' 15.449"	N40° 13' 50.176"
P39	E20° 21' 15.299"	N40° 13' 49.770"
P40	E20° 21' 14.471"	N40° 13' 49.758"
P41	E20° 21' 13.922"	N40° 13' 49.701"
P42	E20° 21' 12.907"	N40° 13' 49.556"
P43	E20° 21' 12.698"	N40° 13' 50.191"
P44	E20° 21' 12.257"	N40° 13' 50.110"
P45	E20° 21' 11.654"	N40° 13' 49.810"
P46	E20° 21' 11.654"	N40° 13' 49.810"
P47	E20° 21' 10.726"	N40° 13' 48.231"
P48	E20° 21' 10.739"	N40° 13' 47.931"
P49	E20° 21' 10.958"	N40° 13' 47.687"
P50	E20° 21' 10.244"	N40° 13' 47.172"
P51	E20° 21' 10.223"	N40° 13' 47.047"
P52	E20° 21' 10.065"	N40° 13' 46.984"
P53	E20° 21' 10.088"	N40° 13' 46.723"
P54	E20° 21' 9.946"	N40° 13' 46.703"
P55	E20° 21' 9.419"	N40° 13' 46.201"
P56	E20° 21' 8.649"	N40° 13' 45.805"
P57	E20° 21' 8.385"	N40° 13' 45.916"
P58	E20° 21' 8.227"	N40° 13' 46.418"
P59	E20° 21' 7.257"	N40° 13' 46.240"
P60	E20° 21' 6.642"	N40° 13' 46.085"
P61	E20° 21' 6.761"	N40° 13' 45.933"
P62	E20° 21' 6.840"	N40° 13' 45.609"
P63	E20° 21' 6.555"	N40° 13' 45.500"
P64	E20° 21' 6.528"	N40° 13' 45.187"
P65	E20° 21' 6.082"	N40° 13' 44.894"
P66	E20° 21' 5.214"	N40° 13' 44.637"
P67	E20° 21' 4.852"	N40° 13' 44.630"
P68	E20° 21' 3.850"	N40° 13' 44.316"
P69	E20° 21' 3.792"	N40° 13' 44.471"
P70	E20° 21' 3.858"	N40° 13' 44.571"
P71	E20° 21' 3.504"	N40° 13' 44.677"
P72	E20° 21' 3.392"	N40° 13' 45.067"
P73	E20° 21' 3.252"	N40° 13' 45.076"
P74	E20° 21' 3.013"	N40° 13' 45.416"
P75	E20° 21' 3.454"	N40° 13' 45.595"
P76	E20° 21' 3.425"	N40° 13' 45.712"
P77	E20° 21' 3.229"	N40° 13' 45.778"
P78	E20° 21' 2.880"	N40° 13' 46.224"
P79	E20° 21' 2.677"	N40° 13' 46.207"
P80	E20° 21' 2.578"	N40° 13' 46.520"
P81	E20° 21' 2.661"	N40° 13' 47.193"
P82	E20° 21' 3.812"	N40° 13' 48.464"
P83	E20° 21' 4.123"	N40° 13' 48.589"
P84	E20° 21' 4.123"	N40° 13' 48.589"
P85	E20° 21' 4.123"	N40° 13' 48.589"
P86	E20° 21' 4.260"	N40° 13' 49.255"
P87	E20° 21' 3.949"	N40° 13' 49.664"
P88	E20° 21' 3.323"	N40° 13' 50.260"
P89	E20° 21' 2.896"	N40° 13' 51.026"
P90	E20° 21' 2.024"	N40° 13' 51.362"
P91	E20° 21' 1.143"	N40° 13' 52.452"
P92	E20° 20' 59.744"	N40° 13' 53.777"
P93	E20° 20' 58.159"	N40° 13' 56.322"



TABELA 2

ZONA E MBROJTUR E QENDRËS HISTORIKE E QYTETIT TË PËRMETIT

1. NËNZONA E MBROTJUR 1

Zona e Mbrojtur I		
UTM Z 34N		
Emërtimi	Long.	Lat.
Z56	E20° 20' 56.145"	N40° 13' 48.360"
Z57	E20° 20' 52.182"	N40° 13' 50.236"
Z58	E20° 20' 51.520"	N40° 13' 51.064"
Z59	E20° 20' 51.554"	N40° 13' 53.502"
Z60	E20° 20' 53.632"	N40° 13' 55.583"
Z61	E20° 20' 53.905"	N40° 13' 56.381"
Z62	E20° 20' 53.281"	N40° 13' 57.561"
Z63	E20° 20' 53.205"	N40° 13' 58.780"
Z64	E20° 20' 52.912"	N40° 13' 59.284"
Z65	E20° 20' 52.801"	N40° 14' 0.228"
Z66	E20° 20' 52.106"	N40° 14' 0.587"
Z67	E20° 20' 51.125"	N40° 14' 0.864"
Z68	E20° 20' 49.353"	N40° 14' 1.027"
Z69	E20° 20' 47.140"	N40° 14' 1.263"
Z70	E20° 20' 45.988"	N40° 14' 1.859"
Z71	E20° 20' 46.201"	N40° 14' 2.196"
Z72	E20° 20' 48.299"	N40° 14' 3.948"
Z73	E20° 20' 49.287"	N40° 14' 5.924"
Z74	E20° 20' 49.896"	N40° 14' 6.310"
Z75	E20° 20' 51.824"	N40° 14' 8.158"
Z76	E20° 20' 54.284"	N40° 14' 10.091"
Z77	E20° 20' 54.853"	N40° 14' 10.713"
Z78	E20° 20' 55.600"	N40° 14' 11.874"
Z79	E20° 20' 55.913"	N40° 14' 12.127"
Z80	E20° 20' 56.390"	N40° 14' 11.619"
Z81	E20° 20' 56.757"	N40° 14' 11.107"
Z82	E20° 20' 56.698"	N40° 14' 10.822"
Z83	E20° 20' 57.128"	N40° 14' 10.557"
Z84	E20° 20' 57.782"	N40° 14' 10.852"
Z85	E20° 20' 59.160"	N40° 14' 10.874"
Z86	E20° 21' 0.174"	N40° 14' 10.042"
Z87	E20° 21' 1.428"	N40° 14' 10.134"
Z88	E20° 21' 2.538"	N40° 14' 10.555"
Z89	E20° 21' 2.260"	N40° 14' 11.311"
Z90	E20° 21' 3.061"	N40° 14' 11.347"
Z91	E20° 21' 3.631"	N40° 14' 11.465"
Z92	E20° 21' 4.205"	N40° 14' 11.751"
Z93	E20° 21' 4.370"	N40° 14' 12.134"
Z94	E20° 21' 5.553"	N40° 14' 12.359"
Z95	E20° 21' 6.862"	N40° 14' 12.401"
Z96	E20° 21' 7.464"	N40° 14' 12.514"
Z97	E20° 21' 7.616"	N40° 14' 12.237"
Z98	E20° 21' 8.120"	N40° 14' 11.644"
Z99	E20° 21' 8.407"	N40° 14' 11.491"
Z100	E20° 21' 8.505"	N40° 14' 10.065"
Z101	E20° 21' 8.661"	N40° 14' 9.257"
Z102	E20° 21' 7.885"	N40° 14' 9.218"
Z103	E20° 21' 3.149"	N40° 14' 8.306"
Z104	E20° 21' 1.644"	N40° 14' 8.258"
Z105	E20° 21' 0.303"	N40° 14' 8.675"
Z106	E20° 21' 0.165"	N40° 14' 7.813"
Z107	E20° 20' 59.802"	N40° 14' 6.580"
Z108	E20° 20' 59.086"	N40° 14' 5.562"
Z109	E20° 20' 58.807"	N40° 14' 4.846"
Z110	E20° 20' 58.294"	N40° 14' 4.267"
Z111	E20° 20' 57.761"	N40° 14' 3.052"
Z112	E20° 20' 57.438"	N40° 14' 1.764"
Z113	E20° 20' 56.194"	N40° 14' 1.634"
Z114	E20° 20' 57.161"	N40° 13' 58.007"
Z115	E20° 20' 57.594"	N40° 13' 56.519"
P93	E20° 20' 58.159"	N40° 13' 56.322"
P92	E20° 20' 58.466"	N40° 13' 55.532"
P91	E20° 20' 59.281"	N40° 13' 54.540"
P90	E20° 20' 59.744"	N40° 13' 53.777"
P89	E20° 21' 1.143"	N40° 13' 52.452"
P88	E20° 21' 2.024"	N40° 13' 51.362"
P87	E20° 21' 2.896"	N40° 13' 51.026"
P86	E20° 21' 3.323"	N40° 13' 50.260"
P85	E20° 21' 3.949"	N40° 13' 49.664"
P84	E20° 21' 4.260"	N40° 13' 49.255"
P83	E20° 21' 4.123"	N40° 13' 48.589"
Z127	E20° 20' 59.136"	N40° 13' 48.278"
Z128	E20° 20' 58.993"	N40° 13' 48.375"
Z129	E20° 20' 58.128"	N40° 13' 48.186"
Z130	E20° 20' 57.831"	N40° 13' 48.010"
Z131	E20° 20' 57.107"	N40° 13' 48.038"



2. NËNZONA E MBROJTUR II

Zona e Mbrojtur II		
UTM Z 34N		
Emertimi	Long.	Lat.
Z1	E20° 20' 57.913"	N40° 14' 1.462"
Z2	E20° 20' 58.116"	N40° 14' 0.164"
Z3	E20° 20' 58.121"	N40° 13' 59.592"
Z4	E20° 20' 58.462"	N40° 13' 58.937"
Z5	E20° 20' 58.682"	N40° 13' 58.192"
Z6	E20° 20' 59.341"	N40° 13' 58.349"
Z7	E20° 20' 59.730"	N40° 13' 58.199"
Z8	E20° 21' 0.098"	N40° 13' 58.435"
Z9	E20° 21' 1.107"	N40° 13' 58.859"
Z10	E20° 21' 1.849"	N40° 13' 57.836"
Z11	E20° 21' 2.155"	N40° 13' 58.036"
Z12	E20° 21' 2.818"	N40° 13' 57.482"
Z13	E20° 21' 3.397"	N40° 13' 57.059"
Z14	E20° 21' 4.075"	N40° 13' 56.620"
Z15	E20° 21' 4.140"	N40° 13' 56.097"
Z16	E20° 21' 6.764"	N40° 13' 54.519"
Z17	E20° 21' 7.951"	N40° 13' 54.157"
Z18	E20° 21' 8.481"	N40° 13' 54.290"
Z19	E20° 21' 10.150"	N40° 13' 53.854"
Z20	E20° 21' 10.430"	N40° 13' 54.473"
Z21	E20° 21' 12.526"	N40° 13' 54.530"
Z22	E20° 21' 13.440"	N40° 13' 54.015"
Z23	E20° 21' 14.080"	N40° 13' 53.385"
Z24	E20° 21' 14.859"	N40° 13' 53.922"
Z25	E20° 21' 15.490"	N40° 13' 53.522"
Z26	E20° 21' 15.824"	N40° 13' 53.072"
Z27	E20° 21' 17.394"	N40° 13' 51.658"
Z28	E20° 21' 16.595"	N40° 13' 51.246"
Z29	E20° 21' 16.734"	N40° 13' 51.079"
Z30	E20° 21' 16.411"	N40° 13' 50.899"
Z31	E20° 21' 16.840"	N40° 13' 50.355"
Z32	E20° 21' 16.964"	N40° 13' 50.005"
Z33	E20° 21' 17.603"	N40° 13' 49.242"
Z34	E20° 21' 17.685"	N40° 13' 48.672"
Z35	E20° 21' 13.281"	N40° 13' 48.408"
Z36	E20° 21' 13.329"	N40° 13' 47.229"
Z37	E20° 21' 12.073"	N40° 13' 46.421"
Z38	E20° 21' 12.046"	N40° 13' 46.273"
Z39	E20° 21' 12.742"	N40° 13' 45.468"
Z40	E20° 21' 12.970"	N40° 13' 45.353"
Z41	E20° 21' 12.840"	N40° 13' 45.156"
Z42	E20° 21' 12.500"	N40° 13' 45.165"
Z43	E20° 21' 12.433"	N40° 13' 45.078"

Z44	E20° 21' 10.523"	N40° 13' 44.586"
Z45	E20° 21' 6.526"	N40° 13' 44.202"
Z46	E20° 21' 4.902"	N40° 13' 43.754"
Z47	E20° 21' 3.581"	N40° 13' 43.952"
Z48	E20° 21' 3.454"	N40° 13' 44.300"
Z49	E20° 21' 2.566"	N40° 13' 44.405"
Z50	E20° 21' 0.211"	N40° 13' 43.832"
Z51	E20° 20' 58.802"	N40° 13' 44.002"
Z52	E20° 20' 54.412"	N40° 13' 42.253"
Z53	E20° 20' 52.382"	N40° 13' 44.002"
Z54	E20° 20' 53.487"	N40° 13' 45.574"
Z55	E20° 20' 55.045"	N40° 13' 45.957"
Z56	E20° 20' 56.145"	N40° 13' 48.360"
Z131	E20° 20' 57.107"	N40° 13' 48.038"
Z130	E20° 20' 57.831"	N40° 13' 48.010"
Z129	E20° 20' 58.128"	N40° 13' 48.186"
Z128	E20° 20' 58.993"	N40° 13' 48.375"
Z127	E20° 20' 59.136"	N40° 13' 48.278"
P83	E20° 21' 4.123"	N40° 13' 48.589"
P84	E20° 21' 4.123"	N40° 13' 48.589"
P85	E20° 21' 4.123"	N40° 13' 48.589"
P86	E20° 21' 4.260"	N40° 13' 49.255"
P87	E20° 21' 3.949"	N40° 13' 49.664"
P88	E20° 21' 3.323"	N40° 13' 50.260"
P89	E20° 21' 2.896"	N40° 13' 51.026"
P90	E20° 21' 2.024"	N40° 13' 51.362"
P91	E20° 21' 1.143"	N40° 13' 52.452"
P92	E20° 20' 59.744"	N40° 13' 53.777"
P93	E20° 20' 58.159"	N40° 13' 56.322"
Z115	E20° 20' 57.594"	N40° 13' 56.519"
Z114	E20° 20' 57.161"	N40° 13' 58.007"
Z113	E20° 20' 56.194"	N40° 14' 1.634"
Z112	E20° 20' 57.438"	N40° 14' 1.764"



RREGULLORE

PËR ADMINISTRIMIN E QENDRËS HISTORIKE TË QYTETIT TË PËRMETIT DHE ZONËS SË MBROJTUR PËRRETH

Neni 1

Qëllimi dhe objektivat

1. Kjo rregullore përcakton detyrimet dhe mënyrat për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e vlerave historiko-kulturore të Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të Përmetit.

2. Objektivat kryesorë të kësaj rregulloreje, janë:

a) administrimi i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të Përmetit, sipas hartës së zonifikimit, që i bashkëngjitet kësaj rregulloreje si pjesë integrale e saj;

b) mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave historiko-kulturore të Qendrës Historike të Përmetit.

3. Kjo rregullore përcakton mënyrat e bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore të qytetit të Përmetit për administrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të Qendrës Historike të Përmetit.

Neni 2

Struktura e hapësirës urbane në mbrojtje

1. Hapësira urbane në mbrojtje e qytetit të Përmetit, për vlerat e saj historiko-kulturore dhe si pjesë e trashëgimisë kulturore i nënshtrohet ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Hapësira urbane me vlera historiko-kulturore në mbrojtje të qytetit të Përmetit, përbëhet nga:

a) Qendra Historike;

b) Zona e mbrojtur.

3. Kufijtë e Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur paraqiten në hartën e zonifikimit të Përmetit, e cila është pjesë integrale e kësaj rregulloreje.

4. Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Përmet duhet të marrë parasysh kufijtë dhe kriteret e mbrojtjes të Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur përreth.

Neni 3

Qendra Historike dhe kufijtë e saj

1. Qendra historike është pjesa më me vlera urbanistiko-arkitektonike e qytetit të Përmetit. Ajo ruan gjini të ndryshme ndërtimore, si: banesa popullore, objekte kulturi dhe ndërtime shoqërore. Këto ndërtime janë të lidhura me peizazhin urbanistiko/arkitektonik historik tradicional i cili është pjesë e saj. Qendra Historike e Përmetit përfshin të gjitha ndërtimet ekzistuese dhe shtrihet kryesisht në lagjet e Shënkollit (Varosh) dhe të Teqesë, të cilat për nga kompozimi i ndërtimeve dhe rrugëve me kalldrëm, janë lagjet ku gjenden gjurmët më të vjetra të qytetit. Brenda Qendrës Historike përfshihen dy objekte kulturi: Kisha e Shën e Premtes (ndërtuar më 1776), monument kulture i kategorisë së parë dhe Kisha e Shën Kollit (ndërtuar në shekullin XIX). Ansambli i ndërtuar paraqet tipologji interesante që përfshin një numër të konsiderueshëm banesash, të vendosura pranë njëra-tjetrës me oborre të vogla dhe një rrjet rrugicash të ngushta të shtriuara me kalldrëm, porta të jashtme druri me perimetër me mure guri. Ndërtimet në përgjithësi janë dykatëshe dhe të ndërtuara me mure guri. Arkitektura është karakteristike e fshatrave tradicionale të zonës dhe pjesa dërmuese e ndërtimeve janë të pas Luftës së Dytë Botërore.

2. Kufijtë e Qendrës Historike paraqiten me koordinata gjeografike sipas tabelës 1, si edhe në hartën e zonifikimit të Qendrës Historike të Përmetit, e cila është pjesë e kësaj rregulloreje.

Neni 4

Ndërhyrjet e lejuara dhe ato që nuk lejohen në Qendrën Historike

1. Në Qendrën Historike nuk lejohen ndërtimet e reja.

2. Me qëllim ruajtjen e vlerave urbanistiko-arkitekturore të Qendrës Historike të Përmetit, brenda kësaj zone lejohen vetëm këto ndërhyrje:

a) Ndërhyrjet sistematike konservuese, restauruese dhe të mirëmbajtjes në Qendrën Historike, si dhe në monumentet e të dyja kategorive mbështeten në kriteret për konservimin dhe restaurimin, të saktësuara në aktet normative kombëtare dhe ndërkombëtare të fushës, të zbatueshme edhe në vendin tonë.



b) Ndërhyrjet restauruese synojnë ruajtjen e hapësirave urbanistiko-arkitekturore, rrjetit rrugor tradicional në kompozim dhe teknikë, si dhe duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit të hapësirave pushuese dhe llojeve të bimësisë tradicionale.

c) Studime për rehabilitimin e pjesëve të veçanta të saj, si dhe me qëndrimin ndaj ndërtimeve, që me volumet dhe formulimin e tyre arkitekturor dëmtojnë vlerat dhe unitetin kompozicional të Qendrës Historike.

ç) Studime të cilat përcaktojnë objektet, ku kryhen punime konservuese dhe restauruese, objektet ku kryhen ritrajtime për të rritur vlerat e tyre, objektet në gjendje rrënoje ose të papërshtatshme për funksionim dhe që cenojnë unitetin arkitekturor të ansamblit ose zonës, ku lejohet të kryhen rikonstruksione, zonat ku lejohet të kryhen ndërhyrje integruese, si dhe parcelat e gjelbëruara.

d) Ndërhyrjet rehabilituese, konservuese dhe restaurimet integruese në objektet brenda Qendrës Historike, për të penguar degradimin e mëtejshëm të tyre dhe për t'i kthyer ato në ndërtime funksionale. Kur rrënojat ruhen dhe paraqesin vlera me rëndësi arkitektonike, kompozicionale dhe tipologji të veçanta, mund të kryhet rikonstruksioni në të njëjtin vëllim, mbi strukturën ekzistuese (mureve perimetrale) me objektiv primar ruajtjen sa të jetë e mundur të karakteristikave origjinale të dukshme, të jashtme dhe të brendshme, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik, mbështetur në tipologjinë, trajtimin arkitektonik, teknikën dhe materialet tradicionale të ndërtimit.

dh) Në rastet e fatkeqësive natyrore, të shembjeve ose djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, rikonstruksioni mund të kryhet mbi strukturat ekzistuese, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik të gjendjes para rrënimit, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik etj.

e) Ritrajtimet dhe rikonstruksionet duhet të integrohen në tërësinë arkitekturore të ansamblit apo të zonës, duke respektuar kompozimet dhe trajtimet e pamjeve të jashtme të ndërtimeve të vëna në mbrojtje, përdorimin e materialeve dhe elementeve arkitektonike tradicionale dhe duke mos tejkaluar lartësinë maksimale 7m deri në kornizën e çatisë.

ë) Në Qendrën Historike ndalohen ndërtimet e reja me përjashtim të rikonstruksionit të rrjetit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksioneve të përmendura në pikat më sipër.

Neni 5

Zona e mbrojtur dhe kufijtë e saj

1. Zona e mbrojtur rrethon Qendrën Historike të Përmetit, shtrihet në pjesën më të madhe veriperindimore të saj. Zona e mbrojtur përbëhet nga një zonë e gjelbër dhe një zonë me ndërtesa të mëvonshme dhe mundëson një kalim të butë prej Qendrës Historike drejt pjesëve më të reja të qytetit. Zona e mbrojtur përbëhet nga dy nënzona si më poshtë:

a) Nënzona I (zonë e gjelbër);

b) Nënzona II.

2. Nënzona I, në pjesën më të madhe përbëhet nga një zonë e gjelbër në perëndim të Qendrës Historike, kryesisht në kodrën e Bolëngës, brenda së cilës përfshihen edhe rrënojat e Kalasë së Bolëngës, monument kulture i kategorisë I, e cila shërben si një kurorë e gjelbër e qytetit dhe mbron peizazhin karakteristik.

3. Nënzona II shtrihet në zonën perëndimore dhe lindore përreth Qendrës Historike dhe përfshin një pjesë banesash të ndërtuara në një kohë më të vonshme se ndërtimet në Qendrën Historike, dhe disa ndërtime të reja, të cilat ruajnë dhe plotësojnë më mirë vlerat e peizazhit dhe të Qendrës Historike dhe krijon një kalim të butë prej saj drejt pjesëve të reja të qytetit.

4. Kufijtë e zonës së mbrojtur, paraqiten në tabelën 2 me koordinata gjeografike, si edhe në hartën e zonifikimit të Qendrës Historike të Përmetit dhe zonës së mbrojtur rreth saj, e cila është pjesë e kësaj rregulloreje.

Neni 6

Ndërhyrjet e lejuara dhe ato që nuk lejohen në zonën e mbrojtur

Ndërhyrjet në zonën e mbrojtur të Qendrës Historike dhe në monumentet e përfshira në këtë zonë, do të kenë si qëllim ruajtjen e vlerave urbanistiko-arkitekturore të qytetit të Përmetit. Ndërhyrjet që lejohen në zonën e mbrojtur janë si më poshtë:

1. Në këtë zonë ruhet pjesa e kurorës së gjelbër, rrjeti rrugor në kompozimin dhe formulimin e tij urbanistiko-arkitektonik. Kjo zonë, si pjesë



përbërëse e Qendrës Historike, ruhet në tërësinë e saj dhe ka elemente që u shërbejnë pamjeve panoramike të Qendrës Historike. Hapësirat ekzistuese të gjelbra ruhen si të tilla, duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit dhe llojshmërinë e drurëve dhe bimësisë tradicionale.

2. Nuk lejohen ndryshimet në rrjetin rrugor ekzistues përveç rikonstruksionit të tij. Ndërhjert e rikonstruksionit në rrjetin rrugor dhe sheshe ruajnë detyrimisht materialet dhe teknikat tradicionale.

3. Në këtë zonë kryhen restaurime, përshtatje, rikonstruksione apo dhe ndërtime të reja për të rritur vlerat brenda saj dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, të cilat duhet të jenë në harmoni me karakterin arkitektonik e urbanistik të qendrës historike.

4. Lartësia maksimale ose numri i kateve duhet të jetë i njëjtë me mesataren e kateve të ndërtesave përreth, me lartësi maksimale jo më shumë se 7m deri në kornizën e çatisë.

5. Kompozimi arkitektonik i ndërtesave duhet t'i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale, duke përdorur stilizime të elementeve morfologjike të saj, të kompozimeve vëllimore, ngjyrave etj.

6. Projektet për përshtatjet, rikonstruksionet apo dhe ndërtimet e reja miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe më pas, procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

Neni 7

Ndarja e monumenteve sipas kategorive

1. Monumentet e Kulturës në Përmet, sipas vlerave të tyre historiko-kulturore ndahen në dy kategori:

- a) monumente të kategorisë I;
- b) monumente të kategorisë II.

2. Ato ndodhen në Qendrën Historike, në zonën e mbrojtur ose në pjesët e tjera të qytetit. Kjo ndarje sipas vlerave, pasqyrohet në shkallën e ruajtjes së tyre, si dhe në mënyrat dhe shkallën e ndërhyrjes konservuese dhe restauruese.

Neni 8

Monumentet e kategorisë I

1. Monumentet e kategorisë së parë janë shembujt me vlera të rëndësishme tipologjike dhe arkitekturore, që pasqyrojnë zhvillimin tipologjik

dhe karakteristikat arkitektoniko-teknike të qytetit të Përmetit.

Monumentet e kategorisë I, me shkallë të mirë autenticiteti, ruhen në përbërësit kompozicionale, arkitekturorë, teknikë dhe të materialeve të ndërtimit. Oborri, muret rrethuese, porta e jashtme dhe ndërtimet ndihmëse, janë pjesë organike e monumentit dhe si të tillë i nënshtrohen të njëjtit trajtim.

2. Në monumentet e kategorisë I, kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme dhe të brendshme, si dhe zgjidhja planimetrike dhe funksionale, nuk mund të ndryshohet, me përjashtim të vendosjes së nyjës higjieno-sanitare kur është e domosdoshme dhe nuk cenon vlerat për të cilat është vënë në mbrojtje. Në rastet kur një pjesë e monumentit ka pësuar dëmtime, transformime ose mungon, mund të ndërmerren ndërhyrje plotësuese sipas gjendjes fillestare.

Neni 9

Monumentet e kategorisë II

1. Monumentet e kategorisë II janë ndërtime me vlera historiko-kulturore, kryesisht si formuese të ansambleve urbanistiko-arkitekturore, marrin pjesë në formulimin kompozicional të qytetit, por dhe ruajnë vlera arkitekturore në vetvete.

2. Monumentet e kategorisë II ruhen në volumet e tyre fillestare dhe trajtimin e tyre arkitekturor të pamjes së jashtme dhe të brendshme në raste të veçanta, kur brenda këtyre monumenteve, sidomos në objektet e banimit, ruhen ambiente karakteristike, si: gdhendje në dru, punime në allçi, dekorime pikturale ose mobilime arkitektonike me vlerë, këto ruhen dhe i nënshtrohen restaurimit, duke përfshirë materialet dhe teknikat tradicionale. Në brendësi të monumenteve të kategorisë së dytë mund të lejohen ndryshime të strukturës kompozicionale dhe përdorimin e teknikave bashkëkohore për të përmirësuar kushtet dhe komoditetin e jetesës, pa cenuar formulimin e pamjes së jashtme, dhe vlerat arkitektonike.

Neni 10

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në Qendrën Historike dhe monumente të veçanta

1. Projektet e restaurimit dhe restaurimi i monumenteve të kulturës bëhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe nga subjekte të



licencuara për këtë qëllim.

Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit.

2. Zbatimi i punimeve të mësipërme kryhet nga Drejtoria Rajonale Kulturës Kombëtare, Gjirokastrë ose nga subjekte të licencuara për restaurim, nën mbikëqyrjen e supervisorit dhe kolaudatorit, caktuar nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK). Për monumentet e kulturës pronë private, pjesa e shpenzimeve që i takon pronarit dhe mënyra e shlyerjes së tyre, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Studimet dhe projektet e rikonstruksioneve hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Gjirokastrë ose nga persona të licencuar në fushën e restaurimeve për këtë kategori projektesh. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura për marrjen e lejes së ndërtimit vazhdon sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

4. Studimet dhe projektet për ndërhyrje në rrjetin rrugor, infrastrukturën nëntokësore dhe rrjetin inxhinierik hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale të Kulturës Kombëtare Gjirokastrë, në bashkëpunim me Bashkinë e Përmetit ose nga persona të licencuar në fushën restaurimeve dhe në kategoritë përkatëse të punimeve. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura për marrjen e lejes së ndërtimit vazhdon sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Neni 11

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në zonën e mbrojtur

1. Studimet për rehabilitimin e imazhit të zonës së mbrojtur hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Gjirokastrë, në bashkëpunim me Bashkinë e Përmetit, ose subjekte të licencuara në fushën e restaurimeve sipas rregullores së miratuar. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura për marrjen e lejes së ndërtimit vazhdon

sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

2. Projektet e rikonstruksionit të ndërtesave, si dhe ato për rehabilitimin e sipërfaqeve të gjelbëruara hartohen nga Bashkia e Përmetit ose nga subjekte të licencuara për këtë kategori punimesh në bazë të një plani të përgjithshëm zhvillimor të hartuar më përpara në përputhje me këtë rregullore. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura për marrjen e lejes së ndërtimit vazhdon sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

3. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit kryhet nga subjekte ndërtimore që janë të licencuara për këtë kategori.

4. Projektet për ndërtimet e reja në këtë zonë, hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim për fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura për marrjen e lejes së ndërtimit vazhdon sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

5. Projektet e rikonstruksionit të rrugëve, shesheve dhe infrastrukturës së tyre të përmendura në nenin 6 hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim për kategorinë përkatëse në fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Neni 12

Zonat e gjelbëruara brenda Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur

1. Këto hapësira janë pjesë përbërëse e qendrës historike dhe zonës së mbrojtur, kanë destinacion publik dhe janë elementë që i shërbejnë pamjeve panoramike të Qendrës Historike. Hapësirat ekzistuese të gjelbëruara ruhen si të tilla.

2. Në këto zona lejohen ndërhyrje për rehabilitimin e sipërfaqeve të gjelbëruara ekzistuese nëpërmjet të cilave mund të realizohen parqe urbane. Në këto zona lejohet mbjellja e pemëve, punimet sistemuese, rregulluese dhe realizimet e



rrugicave të brendshme me karakteristika të njëjta si të kalldrëmeve origjinale të Qendrës Historike, të cilat do të përdoren vetëm për këmbësorë.

3. Në zonat e gjelbra të veçanta të zonës së mbrojtur mund të lejohen ndërtime të reja, si dhe ngritja e strukturave të elementeve të arredimit urban ose ato të shërbimit. Projektet e ndërtimit dhe rehabilitimit të sipërfaqeve të gjelbëruara hartohen nga Bashkia Përmet ose nga subjekte të licencuara për këtë kategori punimesh.

4. Drurët dhe gjelbërimi tradicional i rrugëve e shesheve ruhen dhe pas degradimit ripërtërihen me të njëjtat lloje.

Neni 13

Shfrytëzimi i monumenteve

1. Monumentet e kulturës, janë pjesë e jetës bashkëkohore. Ato shfrytëzohen, sipas rastit, për funksionet për të cilat janë ndërtuar apo dhe për funksione të tjera, me kusht që këto funksione të mos cenojnë vlerat, për të cilat monumenti është vënë në mbrojtje.

2. Shfrytëzimi i monumenteve të kulturës, për funksione të ndryshme prej atyre për të cilat janë ngritur, bëhet vetëm pasi të jetë marrë miratimi i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve. Mënyrat e përdorimit përcaktohen në ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar.

Neni 14

Mbrojtja e monumenteve

1. Organet e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionet shtetërore të specializuara, sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e monumenteve të ngritura në hapësirat e juridiksionit të tyre.

2. Plan i përgjithshëm vendor i Përmetit merr parasysh vlerat e Qendrës Historike të Përmetit dhe zonës së mbrojtur rreth saj.

Neni 15

Komiteti Mbikëqyrës i Qendrës Historike

1. Për të ndihmuar dhe mbikëqyrur veprimtarinë dhe vlerësimin e Qendrës Historike, zonës së mbrojtur, si dhe monumenteve të kulturës në qytetin e Përmetit, pranë Bashkisë së qytetit Përmet ngrihet Komiteti Mbikëqyrës i Qendrës Historike.

2. Ky komitet është një strukturë këshillimore dhe jo vendimmarrëse, i cili përbëhet nga 7 anëtarë. Kryetari i këtij komiteti caktohet nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore të Bashkisë dhe ka në përbërjen e tij përfaqësues të institucioneve shtetërore të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore, të shoqatës së arkitektëve, të përfaqësuesve të banorëve të Qendrës Historike dhe organizmave joshtetërorë, që ushtrojnë veprimtari për mbrojtjen e vlerave historiko-kulturore të Përmetit.

3. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të këtij komiteti përcaktohet në rregulloren e funksionimit të brendshëm që miratohet me 50%+1 të votave të të gjithë anëtarëve.

Neni 16

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen dhe për pasojë nuk zgjidhen në këtë rregullore, sipas kompetencave, ato zgjidhen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

Neni 17

Kundërvajtjet administrative

Shkelja e kësaj rregulloreje ngarkon me përgjegjësi sipas dispozitave të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 18

Dispozita të fundit

1. Shtesat dhe ndryshimet në këtë rregullore bëhen me propozim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Kësaj rregulloreje i bashkëngjitet zonifikimi i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të Përmetit.

2. Kjo rregullore shoqërohet me hartën përkatëse të zonifikimit të Qendrës Historike të Përmetit dhe zonës së mbrojtur rreth saj.

3. Brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi e kësaj rregulloreje, Instituti i Monumenteve të Kulturës në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Gjirokastrë i paraqet për shqyrtim dhe miratim ministrit përgjegjës për trashëgiminë listën e monumenteve të kulturës të kategorive I dhe II.



VENDIM
Nr. 33, datë 18.1.2017

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE PËR
SHËRBIMET E OFRUARA NGA
DREJTORIA PËR TË DREJTËN
E AUTORIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 157, të ligjit nr.35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shërbimet që ofron Drejtoria për të Drejtën e Autorit, sipas aneksit 1,

që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Tarifat e përcaktuara me këtë vendim do të paguhën nga persona fizikë dhe juridikë, që kërkojnë nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit, pranë Ministrisë së Kulturës, kryerjen e shërbimeve të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Pagesat e parashikuara në këtë vendim do të kryhen pranë llogarisë së Ministrisë së Kulturës, në degën e thesarit dhe do të derdhen në buxhetin e shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

ANEKSI 1

Nr.	Shërbimi	Tarifa
1	Regjistrimi i fonogramit shoqëruar me kontratën e kalimit të së drejtës së bashku me lëshimin e certifikatës përkatëse: a) Deri në 20 tituj; b) Nga 21 deri në 50 tituj; c) Nga 51 deri në 100 tituj; ç) Më shumë se 100 tituj.	2 000 lekë 3 000 lekë 4 000 lekë 5 000 lekë
2	Regjistrim i së drejtës së autorit për programet kompjuterike së bashku me lëshimin e certifikatës përkatëse: a) Deri në 20 programe kompjuterike; b) Nga 21 deri në 50 programe kompjuterike; c) Nga 51 deri në 100 programe kompjuterike; ç) Më shumë se 100 programe kompjuterike.	2 000 lekë 3 000 lekë 4 000 lekë 5 000 lekë
3	Regjistrim i së drejtës së autorit për krijimet fotografike së bashku me lëshimin e certifikatës përkatëse: a) Deri në 20 vepra fotografike; b) Nga 21 deri në 50 vepra fotografike; c) Nga 51 deri në 100 vepra fotografike; ç) Më shumë se 100 vepra fotografike.	2 000 lekë 3 000 lekë 4 000 lekë 5 000 lekë
4	Regjistrim i së drejtës së autorit për krijimin origjinal nga autori/autorët së bashku me lëshimin e certifikatës përkatëse: a) Deri në 20 vepra; b) Nga 21 deri në 50 vepra; c) Nga 51 deri në 100 vepra; ç) Më shumë se 100 vepra.	2 000 lekë 3 000 lekë 4 000 lekë 5 000 lekë
5	Lëshimi i dublikatës të certifikatës.	300 lekë
6	Lëshimi i kopjeve të ekstraktit të regjistrimit të së drejtës së autorit.	500 lekë
7	Modifikimi i të dhënave, publikimi i modifikimit të të dhënave të këtyre ndryshimeve ose korrigjimi i të dhënave, si dhe publikimi i korrigjimit të të dhënave në regjistrin e të drejtës së autorit.	2000 lekë ¹
8	Kryen veprimtari profesionale dhe administrative dhe jep asistencë teknike dhe shkencore në lidhje me karakterin origjinal të produkteve të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të, me kërkesë të organeve të hetimit penal dhe me shpenzime të të pandehurve, në qoftë se fajësia e tyre provohet.	5000 lekë

¹ Publikim në faqen web zyrtare të DDA-së.



9	Aplikimi për licencimin ose rilicencim të organizatave si agjenci të administrimit kolektiv.	300 000 lekë
10	Kryen, me kërkesë dhe kundrejt pagesës, hetim administrativ, në favor të palëve të interesuara.	10 000 lekë
11	Administrimi dhe ruajtja e fondit të veprave.	500 lekë
12	Regjistrimi i personave fizik apo juridikë të autorizuar lidhur me kopjen private për të drejtat e riprodhimit.	0 (zero) lekë

VENDIM**Nr. 34, datë 18.1.2017**

**PËR PROCEDURAT E REGJISTRIMIT,
TË ORGANIZIMIT DHE KLASIFIKIMIT
TË VEPRAVE TË TË DREJTAVE TË
AUTORIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PROCEDURAT E REGJISTRIMIT TË TË DREJTAVE TË AUTORIT

1. Procedurat e regjistrimit dhe të pajisjes me certifikatë të të drejtave të autorit kryhen nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit (DDA) pranë ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave.

2. DDA-ja shqyrton dhe regjistron çdo aplikim për regjistrim të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, për subjektin aplikues, autor apo mbajtës/titullar i të drejtave të autorit mbi një vepër.

3. Regjistri i të drejtave të autorit është elektronik dhe dokumentar, i krijuar për të mbajtur të dhënat e të gjitha aplikimeve, regjistrimeve, depozitave, pajisjeve me certifikata dhe të çdo veprimi të ndërmarrë nga DDA-ja.

4. Administrimi i regjistrimit të të drejtave të autorit bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore. Rregulloret për organizimin e funksionimit të brendshëm të tij miratohen me udhëzim të ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave.

5. Regjistri dhe çdo informacion ruhen dhe administrohen nga DDA-ja, në përputhje me ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, ligjin nr. 9154, datë 16.11.2003, “Për arkivat”, dhe u vihen në dispozicion palëve të interesuara, në përputhje me ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”.

6. Regjistri i të drejtave të autorit është i organizuar në klasa administrative dhe organizohet (indeksohet) në bazë të qëllimit dhe aplikimit në DDA, në përputhje me ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

7. DDA-ja, nëpërmjet strukturës përgjegjëse, vë në dispozicion të aplikantëve/subjekteve të interesuara, pa pagesë, formularët-tip të aplikimit. Këta formularë miratohen me udhëzim të ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave.

8. Çdo aplikant/subjekt duhet të paraqesë:

a) formularin-tip, ku kërkohet regjistrimi/pajisja me certifikatë e të drejtave të autorit (e cila do të ketë të dhëna standarde: emër, mbiemër, data e aplikimit, titulli i veprës dhe kategoria e veprës etj.);

b) deklaratë me shkrim, përpara nëpunësit civil të ngarkuar me regjistrimin e të drejtave të autorit, ku autori deklaron, në përgjegjësinë e tij, se ai është autori, krijuesi për veprën ose bashkautor, në rast se ka më shumë se një autor;

c) fotokopje pasaporte ose ID;

ç) mandatin e pagesën për regjistrim të të drejtave të autorit;

d) kopje të veprës në formë të shkruar ose CD, e cila duhet të jetë sa më e detajuar për mbrojtjen e të drejtave të autorit krijues;

dh) çdo dokument tjetër shtesë, të nevojshëm për vërtetimin e të drejtave, objekt regjistrimi.

9. Tarifa për regjistrimin e veprës është e përcaktuar sipas tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit.

10. DDA-ja depoziton të gjitha aplikimet, regjistrimet dhe ndryshimet e të drejtave të autorit, të cilat i mban në bazën e të dhënave që administrohen në Regjistrin e të Drejtave të Autorit.

11. Procedura e regjistrimit pranë DDA-së zgjat në një afat maksimal prej 45 ditësh. Konkretisht, kjo procedurë përfshin:

a) paraqitjen e kërkesës për regjistrim;

b) shqyrtimin e kërkesës (30 ditë);



c) regjistrimin e veprës të së drejtës së autorit (5 ditë);

ç) pajisjen me certifikatë nga ana e DDA-së (10 ditë).

12. DDA-ja vendos pullën artistike të saj, të pakonsumuar, dhe depoziton një kopje origjinale të mbajtësit fonografik/videogramit të veprës ose të mjetit të ngjashëm me të, për riprodhimin e saj.

13. Aplikanti (autori/ët, përfaqësuesit e tyre ligjorë, trashëgimtarët, titullarët e të drejtave të tyre apo agjencitë e administrimit kolektiv) plotëson formularin përkatës dhe ia paraqet DDA-së, të shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, dhe rregulloren e brendshme të ministrisë përgjegjëse për të drejtat e autorit, si dhe çdo informacion tjetër të vlerësuar nga DDA-ja, të vlefshëm për veprën dhe të drejtat mbi të.

14. Certifikata e lëshuar për regjistrimin e të drejtave të autorit dëshmon regjistrimin e një të drejte autori, që gëzon mbrojtje, në zbatim të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, por nuk provon autorësinë e saj.

15. Pajisja me certifikatë bëhet nga struktura përgjegjëse e DDA-së dhe nënshkruhet nga drejtori i saj për titullarët e regjistruar të të drejtave të autorit, që dëshmojnë ndaj të tretëve të drejtat e tyre të regjistruara.

16. Certifikata përmban të dhënat e deklaruara në aplikim, së bashku me numrin dhe datën e regjistrimit, sipas formatit të miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit.

17. Data e regjistrimit të të drejtave të autorit është data kur aplikimi dhe tarifa janë depozituar për regjistrim në DDA.

18. Vendosija e pullës artistike nga DDA-ja është një akt i domosdoshëm. Çdo prodhim i kopjes private duhet të ketë identifikimin e prodhuesit, me shenjë të tij mbrojtëse “P”, të deklaruar pranë DDA-së. Botuesi/prodhuesi i kopjes private, për çdo prodhim/riprodhim, duhet të jetë i pajisur me autorizim nga mbajtësi/titullari/ët e të drejtave të autorit ose agjencitë e administrimit kolektiv. Po ashtu, çdo prodhim ose çdo kopje private, që hyn nga jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, duhet të pajiset me pullën e DDA-së. Kjo pullë duhet të ketë të gjitha elementet e sigurisë, bazuar në numrin serial dhe logon e integruar brenda

pullës së prodhuar. Pulla mund të përmbajë edhe çdo element tjetër që rrit origjinalitetin e saj, e cila mund të prodhohet brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, me garancitë e duhura identifikuese.

II. PROCEDURA E ORGANIZIMIT DHE E KLASIFIKIMIT ADMINISTRATIV TË TË DREJTAVE TË AUTORIT

1. Organizimi (indeksimi) dhe klasifikimi administrativ i regjistrit të të drejtave të autorit bëhen, si më poshtë vijon:

a) Regjistrimi i të drejtave të autorit dhe i të drejtave të tjera të lidhura me to;

b) Regjistrimi i kontratave dhe marrëveshjeve që kanë objekt të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to (të shoqëruara me dokumente shtesë, që provojnë kalimin e të drejtave nga pronari ose autori i veprës kundrejt titullarit të të drejtave të fituara);

c) Regjistrimi i agjencive të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit dhe të të drejtave të lidhura me të, të licencuara, si dhe çdo informacion që këto agjenci detyrohen të paraqesin në DDA;

ç) Pajisja me certifikatë për çdo të drejtë të regjistruar dhe/ose i çdo kalimi të të drejtave, sipas kërkesave të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”;

d) Depozitimi, sipas nenit 104, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.

2. Në çdo rast të parashikuar në pikën 1, të këtij kreu, strukturat përgjegjëse të DDA-së bëjnë organizimin (indeksimin) e të dhënave për çdo ndryshim të ndodhur, të bërë nga subjektet dhe/ose organet gjyqësore dhe të pasqyruar në regjistrin e DDA-së.

3. Organizimi (indeksimi) i të dhënave në regjistrin e të drejtave të autorit rrit, por nuk zë vendin e të dhënave përmbajtëse në regjistrimin e mëparshëm.

4. Dokumentet e paraqitura nga aplikantët për regjistrimin e të drejtave të autorit dhe të të drejtave të lidhura me to duhet të jenë origjinale ose kopje të njësuara me origjinalin, sipas legjislacionit në fuqi, të tre muajve të fundit.

5. Deklaratat që depozitohen nga autorët, përfaqësuesit e tyre ligjorë apo titullarët e të drejtave duhet të jenë origjinale dhe të nënshkruara nga vetë këto subjekte.

6. Struktura përgjegjëse që shqyrton aplikimin, dokumentacionin dhe të dhënat e kërkuara në këtë



kre, ka të drejtë të kërkojë plotësimin e dokumentacionit dhe korrigjimin e të metave mbi regjistrimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të.

7. Struktura përgjegjëse në DDA, që shqyrton aplikimin, dokumentacionin dhe të dhënat e kërkuara në këtë kre, ka të drejtë të refuzojë regjistrimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to dhe të njoftojë me shkrim aplikantin për këtë refuzim.

8. DDA-ja refuzon regjistrimin dhe pajisjen me certifikatë të çdo kontrate, e cila është bërë në kundërshtim me nenet 60 dhe 104 të ligjit, si dhe me ato dispozita ligjore në fuqi që përcaktojnë depozitimin e detyruar të kopjes origjinale të veprës.

9. Ankimi për refuzimin e këtij regjistrimi bëhet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.

10. Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 35, datë 18.1.2017

PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT, TË ORGANIZIMIT DHE TË SHPËRBLIMIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT (KKDA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 156, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Miratimin e mënyrës së funksionimit dhe të organizimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit (në vijim “KKDA”), si organ i specializuar, për vendosjen e tarifave të shpërblimit mbi shfrytëzimin e veprave të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në administrimin kolektiv, objekt i përcaktimit të ligjit për të drejtat e autorit.

2. Misioni i KKDA-së është garantimi dhe mbrojtja e mbajtësve të së drejtës, subjekt të të drejtave të autorit, për sa i përket shpërblimit për shfrytëzimin e të drejtave me karakter pasuror ose jopasuror në tregun intelektual.

3. KKDA-ja funksionon në përputhje me parimin e transparencës dhe bashkëpunimit me agjencitë e administrimit kolektiv dhe shoqatat përfaqësuese të përdoruesve.

II. FUNKSIONIMI DHE ORGANIZIMI

1. KKDA-ja është organ kolegjal vendim-marrës dhe këshillimor, pranë ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit dhe përbëhet nga kryetari dhe 4 (katër) anëtarë. Anëtarët e KKDA-së kanë detyrimin të deklarojnë konfliktin e interesit me secilën prej palëve në çdo rast të mundshëm dhe në rast vërtetimi të këtij konflikti detyrohen të mos jenë pjesë e vendimarrjes në procedurën përpara KKDA-së, sipas legjislacionit në fuqi për konfliktin e interesave. Çdo anëtar, paraprakisht, duhet të deklarojë marrëdhëniet, nëse kanë, me autorët e veprës ose titullarët e të drejtave, AAK-të ose përdoruesit.

2. Emërimi i anëtarëve bëhet nga ministri përgjegjës për të drejtën e autorit, sipas pikës 1, të nenit 156, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, duke marrë parasysh shmangien nga çdo interes direkt ose indirekt të mundshëm të tyre me subjektet që ndikohen nga vendimet e KKDA-së, si dhe duke u bazuar në kriteret e përgjithshme të mëposhtme:

a) të zotërojnë diplomë universitare të ciklit të parë dhe të dytë në fushën juridike, ekonomike, shkencave sociale ose shkencave ekzakte;

b) të kenë njohuri të gjuhës angleze;

c) të kenë më shumë se 5 vite përvojë pune profesionale në fushat e sipërpërmendura.

3. KKDA-ja ka detyrimin që të njoftojë shoqatat e përfaqësuesve kryesorë të përdoruesve ose përdoruesit kryesorë, për të marrë pjesë në seancat ku diskutohet për miratimin e metodologjisë dhe masën e tarifave të shpërblimit për kategorinë e të drejtave përkatëse, të paktën, 5 (pesë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhje. Këto shoqata ose përdorues kryesorë kanë të drejtë të propozojnë dhe të japin opinionin e tyre verbalisht ose me shkrim, por, në asnjë rast, nuk kanë të drejtë vote për vendimarrje në KKDA.

4. Palët e përmendura në pikën 3 duhet të jenë



aktive dhe të gatshme në përgjigjet ndaj KKDA-së për çdo informacion shtesë të kërkuar në funksion të çështjes, objekt vendimmarrjeje. Në vendimin përfundimtar KKDA-ja mban parasysh dhe analizon propozimet ose opinionet e shprehura të tyre.

5. KKDA-ja kryen kompetencat në bazë të pikës 4, të nenit 156, dhe ndjek procedurat e miratimit të tarifave të shpërblimit në përputhje me nenin 142 dhe vijues, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.

6. KKDA-ja, përveç sa parashikohet në këtë vendim mund të miratojë rregulloren për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të brendshëm të saj.

7. KKDA-ja shqyrton kërkesat e secilës palë dhe vendos për çdo çështje të ngritur që ka lidhje me objektin e funksionimit të këtij Këshilli.

8. KKDA-ja thërret mbledhjet sipas njoftimit të kryetarit. Mbledhjet janë të vlefshme kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët e saj. Në zbatim të shkronjës “a”, të pikës 4, të nenit 156, të ligjit nr. 35/2016, numri i mbledhjeve që zhvillon KKDA-ja, si rregull, është 5 (pesë).

9. Kryetari thërret mbledhjet e KKDA-së “ad hoc” ose pasi ka vlerësuar kërkesën e paraqitur në zbatim dhe në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 35/2016, për kompetencat e tjera të përcaktuara në pikën 4, të nenit 156, të këtij ligji, përveç atyre të përcaktuara në shkronjën “a” të këtij neni. Në çdo rast, kryetari duhet të tregojë arsyet e mbledhjes apo të refuzimit të kërkesës për mbledhjen e KKDA-së.

10. Në rast të mosarritjes së kuorumit të kërkuar, sipas pikës 8, kryetari thërret mbledhjen pasardhëse jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë nga data e anulimit të mbledhjes. Kryetari ndërmerr të gjitha masat paraprakisht në mënyrë që mbledhja e radhës të zhvillohet normalisht për objektin për të cilën është thirrur.

11. Njoftimit për thirrjen e mbledhjes i bashkëlidhet rendi i ditës dhe materialet e çështjeve për të cilat do të diskutohet në mbledhje. Rendi i ditës miratohet nga kryetari, pas propozimit të sekretarisë teknike të KKDA-së (Drejtoria për të Drejtën e Autorit) apo të anëtarëve të Këshillit. Njoftimi, ku përcaktohen rendi i ditës dhe materialet që do të diskutohen në mbledhje, përgatiten dhe njoftohen nga sekretaria teknike, të

paktën, 5 (pesë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhje. Në raste të veçanta, kur për një gjë të tillë bien dakord shumica e anëtarëve të KKDA-së, mbledhja mbahet edhe më parë se data e njoftimit.

12. Mbledhjet e KKDA-së drejtohen nga kryetari.

13. Me shumicën e anëtarëve, KKDA-ja duke marrë edhe mendimin e palëve, mund të kërkojë ndihmën e një eksperti për çështje të veçanta, objekt i vendimmarrjes nga ky Këshill, të cilat janë specifike dhe kërkojnë nevojën e ekspertizës profesionale dhe shkencore në funksion të vendimmarrjes së KKDA-së. Kryetari thërret ekspertin dhe përcakton me vendim modalitetet e paraqitjes së raportit të tij para KKDA-së. Në këtë rast palët mbulojnë në mënyrë të barabartë koston e ekspertimit në procedurën përpara KKDA-së sipas urdhrit të ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit në zbatim të nenit 146, të ligjit nr. 35/2016.

14. Sekretaria teknike e KKDA-së (DDA) mban procesverbalin e mbledhjeve, i cili përfshin:

- a) orën, datën, vendin e mbledhjes;
- b) listëprezencën e pjesëmarrësve në mbledhje;
- c) çështjet e diskutuara nga anëtarët e Këshillit;
- ç) formën dhe rezultatin e votimeve;
- d) çdo informacion apo dokument, objekt diskutimi dhe vendimmarrjeje.

15. Procesverbali u paraqitet për shqyrtim e miratim anëtarëve të Këshillit në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Në rastet kur çështjet e propozuara zgjasin më shumë se një mbledhje, procesverbali miratohet nga anëtarët e Këshillit në përfundim të mbledhjes përkatëse.

16. Vendimet e KKDA-së merren me votim të hapur dhe duhet të jenë të arsyetuara. Anëtarët e KKDA-së në mbledhje dhe që nuk kanë ndonjë pengesë ligjore apo rrethana të tjera për të votuar, nuk mund të abstenojnë. Në vendimin e KKDA-së përcaktohet edhe mbulimi i shpenzimeve nga palët sipas nenit 146, të ligjit nr. 35/2016 për të drejtat e autorit.

17. Anëtarët e KKDA-së, që janë të pranishëm në mbledhje, diskutojnë dhe votojnë për vendimmarrjen e një çështjeje të caktuar, me përjashtim të rasteve kur kanë pengesë ligjore në kuptim të nenit 30, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, konfliktit të interesit, diskriminimit ose rasteve të tjera të ndaluara me ligj. Në këto raste, anëtari i Këshillit njofton kryetarin për



mospjesëmarrjen në diskutimin dhe votimin e çështjes së caktuar që pritet të zhvillohet në mbledhjen e Këshillit.

18. Kryetari i KKDA-së voton i fundit. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare. Vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të saj. Vendimet e KKDA-së nënshkruhen nga kryetari.

19. KKDA-ja publikon në vendimin e marrë edhe mendimin e arsyetuar të anëtarit/anëtarëve që kanë votuar në pakicë dhe shënon në procesverbal faktin dhe arsyet e votimit kundër vendimit.

20. Në rastet e dorëheqjes, ndërprerjes së mandatit apo çdo rrethane tjetër që e pamundëson votimin e anëtarit në mbledhje në procedurën përpara KKDA-së, vendimi merret me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve në detyrë. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e kryetarit përbën shumicën absolute të vendimmarrjes.

III. SHPËRBLIMI I ANËTARËVE TË KKDA-së

1. Shpërblimi për pjesëmarrje në mbledhje, për çdo anëtar, bëhet sipas përcaktimeve të bëra në vendimin nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjësive të qeverisjes qendrore”, i ndryshuar.

2. Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 36, datë 18.1.2017

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS SË TRANSMETIMIT 110 KV LAÇ-SKURAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen

në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës së transmetimit 110 kV Laç-Skuraj, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “tokë arë” dhe “truall”, me sipërfaqe të përgjithshme 665.5 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë pesë) m², me vlerë totale të shpronësimit prej 194 197.2 (njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë dy) lekësh.

4. Vlera totale e shpronësimit prej 194 197.2 (njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë dy) lekësh dhe të gjitha shpenzimet procedurale të përballohen nga fondet e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., si subjekti kërkues i këtij shpronësimi.

5. Shpronësimi të fillojë brenda muajit janar 2017.

6. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kurbini të marrin masat për pezullimin e të gjitha transaksioneve mbi këto pasuri, deri në përfundimin e procesit të kalimit të pronësisë, të pasurive të shpronësuara, në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.

7. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kurbini për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi



LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT
TË LINJËS 110 KV SKURAJ-LAÇ
LLOJI I PASURISË SË PALUAJTSHME QË SHPRONËSOHET: TOKË ARË, TRUALL

Nr.	Numri i shtyllës	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sasia Sip. pronës m ²	Sipërfaqja e shpronësimit m ²	Çmimi i tokës lekë/m ²	Vlera e shpronësimit në lekë	Shënime
Bashkia Kurbin												
Ferr Shkopet												
1	43	Pretendent			Arë	3470	32		15.16	278	4214.5	
Skuraj												
2	49	Gjon	Dode	Preni	Arë + Truall	3469	52	4750	65.87	278	18311.9	Pa certifikatë
Milot												
3	66	Ismail	Xhemal	Kasmi	Truall	2693	2/52	818	47.83	278	13296.7	Bashkëpronësi
4	68	Pretendent			Arë	2693	40		15.16	278	4214.5	Nuk ka të dhëna
5	69	Pretendent			Arë	2693	156/1		15.16	278	4214.5	Nuk ka të dhëna
6	71	Pretendent			Arë	2693	44/48		47.83	278	13296.7	Nuk ka të dhëna
7	72	Pretendent			Arë	2693	55/28 55/29		23.17	278	6441.3	Nuk ka të dhëna
8	73	Pretendent			Arë	2693	63/9		15.16	278	4214.5	Nuk ka të dhëna
9	74	Pretendent			Arë	2693	107/6		15.16	278	4214.5	Nuk ka të dhëna
10	75	Pretendent			Arë	2693	108/8		15.16	278	4214.5	Nuk ka të dhëna
11	76	Pretendent			Arë	2693	109/11		15.16	278	4214.5	Nuk ka të dhëna
12	77	Pretendent			Arë	2693	110/6		15.16	278	4214.5	Nuk ka të dhëna
13	78	Pretendent			Arë	2693	111/3		47.83	278	13296.7	Nuk ka të dhëna
Fshat Laç												
14	80	Pretendent			Arë	2365	113/1		47.83	321	15353.4	Nuk ka të dhëna
15	81	Pretendent			Arë	2365	96		16.59	321	5325.4	Nuk ka të dhëna
16	82	Pretendent			Arë	2365	96		47.83	321	15353.4	Nuk ka të dhëna
17	83	Pretendent			Arë	2365	96		15.16	321	4866.4	Nuk ka të dhëna
18	87	Anton	Prend	Miza	Arë	2365	45/31	900	15.16	321	4866.4	
19	88	Preng	Kol	Nezha	Arë	2365	60/2	2030	15.16	321	4866.4	
20	90	Mhill	Vlash	Noka	Arë	2365	60/20	15900	76.98	321	24710.6	Pa certifikatë
21	91	Llesh	Nikoll	Ruka	Arë	2365	56/13	5334	76.98	321	24710.6	Certifikatë
									Σ =	665.50	Σ =	194197.2

Sipërfaqe totale shpronësimi 665.5 m²

Vlera totale e shpronësimit 194197.2 lekë

VENDIM

Nr. 37, datë 18.1.2017

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 110/20 KV GJIRI I LALËZIT, DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 110/20 kV Gjiri i Lalëzit, Durrës, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me vlerë totale të shpronësimit prej 152 567.1 (njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë një) lekësh.

4. Vlera totale e shpronësimit prej 152 567.1 (njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë një) lekësh dhe vlera e shpenzimeve procedurale të përballohen nga fondet e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., si subjekti kërkues i këtij shpronësimi.

5. Shpronësimi të fillojë brenda muajit janar 2017.

6. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës të marrin masat për pezullimin e të gjitha transaksioneve mbi këto pasuri, deri në përfundimin e procesit të kalimit të pronësisë, të pasurive të shpronësuar, në favor të OSHEE sh.a.



7. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a. dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, PËR NDËRTIMIN E NËNSTACIONIT 110/20 KV GJIRI I LALZIT DURRËS, FSHATI KURATEN, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM

Nr.	Pronari	ZK	Nr. Pasurisë	Lloji	Sipërfaqja	Çmimi	Vlera	Shënime
1	Thoma Çuni	2332	242/2	Arë	384.3	397	152 567.1	Konfirmim nga ZVRPP-ja
2	Shtet	2332	242/1	Kullote	3615.7			Konfirmim nga ZVRPP-ja

VENDIM
Nr. 38, datë 18.1.2017

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË
NDËRVEPRUESHMËRISË TË TË
DHËNAVE, GRUPEVE TË TË DHËNAVE
DHE SHËRBIMEVE GJEOPHAPËSINORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr.72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave të ndërveprueshmërisë të të dhënave, grupeve të të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore, sipas tekstit bashkë-lidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe autoritetet përgjegjëse për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

RREGULLAT
E NDËRVEPRUESHMËRISË
TË TË DHËNAVE, GRUPEVE TË TË
DHËNAVE DHE SHËRBIMEVE
GJEOPHAPËSINORE

KREU I
FUSHA E VEPRIMIT DHE PËRKUFIZIME

Fusha e veprimit

Ky dokument përcakton rregullat dhe kërkesat për përgatitjet teknike për ndërveprimin dhe, kur është e mundur, harmonizimin e të dhënave, grupeve të të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore, që i përkasin temave të nenit 11, të ligjit nr. 72, datë 28.6.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

Përkufizime

Për qëllime të këtij dokumenti, do të përdoren përkufizimet e mëposhtme:

1. “Tipi abstrakt” nënkupton një element i cili nuk është element real në terren, por konsiderohet vetëm si fenomen. (Ka të njëjtin kuptim me atë të përdorur në “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri” për temat e nenit 11, të ligjit nr. 72/2012).

2. “Rol shoqërimi” nënkupton një vlerë ose objekt, me të cilët një tip ka një lidhje, siç referohet në nenin 18, të ligjit nr. 72/2012.

3. “Atribut” nënkupton një karakteristikë të një tipi, siç referohet në nenin 18, të ligjit nr. 72/2012.

4. “Kod - listë” nënkupton një listë vlerash të përcaktuara. Në dokument gjenden të shqipëruara si “Numërtimet dhe kod-listat”. (Ka të njëjtin



kuptim me atë të përdorur në “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri” për temat e nenit 11, të ligjit nr. 72/2012).

5. “Data - type” nënkupton një element tabelor i cili shërben vetëm si tabelë atributesh për t’u lidhur me një element tjetër. (Ka të njëjtin kuptim me atë të përdorur në “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri” për temat e nenit 11, të ligjit nr. 72/2012). Në përputhshmëri me ISO/TS 19103:2005.

6. “Numërtimet” nënkupton një renditje vlerash. Listë e parapërgatitur vlerash ku elementi duhet të marrë vlerë. (Ka të njëjtin kuptim me atë të përdorur në “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri” për temat e nenit 11, të ligjit nr. 72/2012).

7. “Identifikues i jashtëm i objektit” nënkupton një identifikues unik objektesh, i cili krijohet nga autoriteti përgjegjës, që mund të përdoret nga aplikimet e jashtme për të referuar objektin gjeohapësinor.

8. “Identifikues” nënkupton një vijimësi të pavarur karakteresh të aftë për të identifikuar në mënyrë unike një element të caktuar.

9. “Ilustrim me shembull konkret” nënkupton të krijosh një objekt që është në përputhje me përkufizimin, atributet, rolet e shoqërimit dhe kufizimet e specifikuara për tipin e ilustruar me shembull konkret.

10. “Shtresë” nënkupton njësinë themelore të informacionit gjeografik që mund të kërkohet në hartë nga një server. (Ka të njëjtin kuptim me atë të përdorur në “Rregullat për shërbimet e rrjetit”.)

11. “Cikli jetësor” nënkupton historinë e një grupi të dhënash, ciklin e jetës së tyre nga mbledhja, përdorimi dhe përditësimi i tyre deri në formën aktuale, në përputhje me EN ISO 19101. (Ka të njëjtin kuptim me atë të përdorur në vendimin nr. 1077, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë”.)

12. “Element i metadatave” nënkupton një njësi diskrete të metadatës, në përputhje me EN ISO 19115. (Ka të njëjtin kuptim me atë të përdorur në vendimin nr. 1077, datë 23.12.2015, të

Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë”.)

13. “Paketë” nënkupton një grup elementesh me karakteristika të përbashkëta me qëllim organizimin e tyre.

14. “Regjistër” nënkupton një grup skedarësh që përmbajnë identifikues të caktuar për artikujt, shoqëruar me përshkrime të tyre.

15. “Tipi i objektit gjeohapësinor” nënkupton një klasifikim të objekteve gjeohapësinore sipas një tipologjie të caktuar.

16. “Stil” nënkupton veçori të objekteve gjeohapësinore dhe kufizimeve në simbole të parametrizuara, që përdoren në hartë.

17. “Tip” nënkupton tipin e objektit gjeohapësinor ose të të dhënave gjeohapësinore.

18. “Nëntip” nënkupton një marrëdhënie mes një tipi specifik e një tipi më të përgjithshëm, ku tipi specifik është plotësisht në përputhshmëri me tipin e përgjithshëm dhe përmban informacion shtesë.

19. “I shmangshëm” (voidable) nënkupton që një atribut ose rol shoqërimi me vlerë ‘e shmangshme’ (void) mund të bëhet e disponueshme, nëse përfshihet një vlerë korresponduese në grupet e të dhënave gjeohapësinore, përcaktuar nga autoritetet përgjegjëse. Nëse një atribut ose rol shoqërimi nuk është i shmangshëm, kuadrati i tabelës që specifikon të qenit i shmangshëm lihet bosh.

20. “Karakteristika” nënkupton atribut ose rol shoqërimi (*association role*).

21. “Tip bashkimi” nënkupton një tip që përbëhet nga një ose vetëm një nga disa alternativa (listuar si attribute pjesëmarrëse), në përputhje me ISO/TS 19103:2005.

22. “Kategori shoqërimi” nënkupton një tip që përcakton tipare shtesë në një marrëdhënie mes dy tipash të tjerë.

23. “Mbulim” (Coverage), funksionet “Coverage” përdoren për të përshkruar karakteristikat e një fenomeni të botës reale që zhvillohet në kohë dhe/ose hapësirë. Shembuj tipikë janë temperaturat, lartësitë, precipitimet, imazheria etj. Një “Coverage” përmban një grup vlerash, të cilat shoqërohen me një element gjeohapësinor, kohor, kohor-hapësinor, në përputhje me ISO 19123:2007.



24. **“Domain”** nënkupton një bashkësi vlerash të mirëpërcaktuara, në përputhje me ISO/TS 19103:005.

25. **“Gamë”** nënkupton një grup vlerash, atributesh e tiparesh të shoqëruara nga një funksion me elemente të domain-it.

26. **“Rrjet koordinativ i rektifikuar (transformuar)”** nënkupton një rrjet koordinativ për të cilin ka një transformim afim përkatës mes koordinatave të rrjetit dhe koordinatave të një sistemi referimi koordinativ.

27. **“Rrjet koordinativ referues”** nënkupton një rrjet, të shoqëruar me një transformim, që mund të përdoret për të shndërruar vlerat e rrjetit të koordinatave në vlera koordinatash referuar një sistemi të jashtëm referimi, sipas EN ISO 19123:2007.

28. **“Mozaik”** nënkupton një ndarje të hapësirës në një grup nënhapësirash fqinje duke pasur të njëjtin dimension në hapësirën e ndarë. Një mozaik në një hapësirë 2D përbëhet nga një grup shumëkëndëshash pa mbivendosje, që mbulojnë krejtësisht një rajon interesash.

29. **“Vlera paraardhëse”** nënkupton një vlerë që ka marrëdhënie hierarkike me një vlerë mëmë me të përgjithshme.

30. **“Offset”** nënkupton mbivendosje të vlerës së një atributi, kryesisht i shprehur në sistemin binar 1/0. 1 tregon vlerat negative ndërsa zero vlerat pozitive. Gjithmonë i referohet një vlere të mëparshme.

31. **“Tipologji”** nënkupton një element i cili mund të jetë real në terren apo një fenomen abstrakt. (Ka të njëjtin kuptim me atë të përdorur në “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri” për temat e nenit 11, të ligjit nr. 72/2012).

KREU II

RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Tipat e zakonshëm

Tipat që janë të zakonshëm për një numër temash të nenit 11, të ligjit nr. 72/2012, duhet të përputhen me përkufizimet, kufizimet dhe duhet të përfshijnë atributet dhe rolet e shoqërimit, të përcaktuara në kreun III.

2. Tipat për shkëmbimin dhe klasifikimin e objekteve gjeohapësinore

a) Për shkëmbimin dhe klasifikimin e objekteve gjeohapësinore nga grupet e të dhënave që

plotësojnë kushtet e nenit 2, të ligjit nr.72/2012, autoritetet përgjegjëse do të përdorin tipat e objekteve gjeohapësinore dhe *data-type*-ve të shoqërimit, numërtimet dhe kod-listat, që janë të përcaktuara në “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor për çdo temë të nenit 11, të ligjit nr. 72/2012, për motivet me të cilat lidhen grupet e të dhënave.

b) Tipat e objekteve gjeohapësinore dhe *data-type*-ve do të përputhen me përkufizimet dhe kufizimet dhe do të përfshijnë atributet e rolet e shoqërimit, të përcaktuara në këto standarde.

c) Numërtimet dhe kod-listat e përdorura në atributet apo rolet e shoqërimit të tipave të objekteve gjeohapësinore ose *data-type*-ve, do të përputhen me përkufizimet dhe do të përfshijnë vlerat e përcaktuara në standardin përkatës për çdo temë.

c) Renditja dhe vlerat e kod-listës identifikohen në mënyrë unike nga kodet unike të gjuhës së programimit për kompjuterat. Vlerat mund edhe të përfshijnë një emër të një gjuhe specifike për t'u përdorur nga përdoruesit e thjeshtë.

3. Tipat

a) Për të gjitha tipat e përcaktuar në këto rregulla jepet një emër neutral për gjuhën kompjuterike mes thonjësive në titullin e pjesës ku specifikohen kërkesat për këtë tip. Ky emër i gjuhës kompjuterike do të përdoret për t'u referuar tipit korrespondues në përkufizimin e një atributi ose roli shoqërimi.

b) Tipat që janë një nëntip i një tipi tjetër do të përfshijnë gjithashtu të gjitha atributet e këtij tipi dhe rolet e tij të shoqërimit.

c) Tipat abstrakte nuk do të ilustron me shembuj konkretë.

4. Numërtimet dhe kod-listat

4.1 Kod-listat do të jenë njëra nga tipat vijues, siç janë specifikuar në “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri” për çdo temë të nenit, 11, të ligjit nr. 72/2012.

a) Kod-listat, vlerat e lejuara të të cilave përbëhen vetëm nga vlerat e specifikuara në këto rregulla;

b) Kod-listat, vlerat e lejuara të të cilave përbëhen nga vlerat e specifikuara në këto rregulla dhe vlerat më të rëndësishme, të përcaktuara nga ofruesit e të dhënave;



c) Kod-listat, vlerat e lejuara të të cilave përbëhen nga vlerat e specifikuara në këto rregulla dhe vlerat shtesë të çdo niveli, të përcaktuara nga ofruesit e të dhënave;

ç) Kod-listat, vlerat e lejuara të të cilave përbëhen nga çdo vlerë e përcaktuar nga ofruesit e të dhënave.

4.2 Kod-listat mund të jenë hierarkike. Vlerat hierarkike të kod-listave mund të kenë një vlerë mëmë më të përgjithshme. Aty ku vlerat e vlefshme të një kod-liste specifikohen në një tabelë në këto rregulla, vlerat mëmë janë listuar në shtyllën e fundit.

4.3 Aty ku për një atribut, tipi i të cilit është një kod-listë, siç referohet në shkronjat “b”, “c” ose “ç”, të nënpikës 4.1, një ofrues të dhënash jep një vlerë, që nuk është specifikuar në këto rregulla, ajo vlerë dhe përkufizimi i saj do të bëhen të disponueshme në një regjistër.

4.4 Atributet ose rolet e shoqërimit të tipave të një objekti gjeohapësinor ose *data-type*-ve, tipi i të cilave është një kod-listë, mund të marrë vetëm vlera që lejohen në përputhje me specifikimin në kod-listë.

4.5 Atributet ose rolet e shoqërimit të tipave të një objekti gjeohapësinor ose të *data-type*-ve, që kanë një tip numërimi mund të marrin vlera vetëm nga listat e specifikuara për tipin e numërimit.

5. Kodimi

a) Çdo rregull kodimi, i përdorur për të koduar të dhënat gjeohapësinore, duhet të jetë konform EN ISO 19118. Në veçanti, duhet të specifikojë rregullat e shndërrimit të skemës për të gjithë tipat e objekteve gjeohapësinore dhe të gjitha tiparet e rolet e shoqërimit, si dhe strukturën e përdorur të të dhënave si *output*.

b) Do të vihet në dispozicion çdo rregull kodimi i përdorur për të koduar të dhënat gjeohapësinore.

6. Përditësimet

a) Autoritetet përgjegjëse, për çdo temë, do të vënë në dispozicion të ASIG-ut rregullisht përditësimet e të dhënave.

b) Të gjitha përditësimet duhet të kryhen të paktën 6 muaj pas aplikimit të ndryshimit të grupeve të të dhënave burimore, pavarësisht se për përditësimet e të dhënave gjeohapësinore specifike janë caktuar periudha të ndryshme në standardet përkatëse të temës.

7. Menaxhimi i identifikuesit

a) Identifikuesi i *data-type*-ve, përcaktuar në pikën 2.1 të (kreut III), do të përdoret si një tip për identifikuesin e jashtëm të objektit si një objekt gjeohapësinor.

b) Identifikuesi i jashtëm i objektit për identifikimin unik të objekteve gjeohapësinore nuk do të ndryshojë gjatë ciklit të jetës së një objekti gjeohapësinor.

8. Cikli i jetës së objekteve gjeohapësinore

a) Versionet e ndryshme të të njëjtit objekt gjeohapësinor do të jenë gjithmonë shembuj të të njëjtit tip të objektit gjeohapësinor.

b) Tiparet e hapësirës së emrit dhe ID lokale të identifikuesit të objektit të jashtëm do të mbeten të njëjtë për versione të ndryshme të një objekti gjeohapësinor.

c) Aty ku përdoren tiparet, fillimi i ciklit jetësor dhe përfundimi i ciklit jetësor, vlera e përfundimi i ciklit jetësor nuk do të vendosen para vlerës së fillimi të ciklit jetësor.

9. Referenca kohore

a) Do të përdoret referenca kohore e përzgjedhur, referuar në vendimit nr. 1077, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë” nëse nuk janë specifikuar sisteme të tjera reference kohore për një motiv specifik të dhënash, në standardet përkatëse sipas temave.

b) Nëse përdoren sisteme të tjera reference kohore, këto do të specifikohen në metadatat e grupit të të dhënave të temës përkatëse.

10. Kërkesa dhe rregulla të tjera

a) Të gjitha vlerat e matjeve do të shprehen duke përdorur njësitë e sistemit SI ose njësitë jo-SI, të pranuar për përdorim në Sistemin Ndërkombëtar të Njësive, nëse nuk është specifikuar ndryshe për një motiv ose tip specifik të dhënash gjeohapësinore.

b) Aty ku përdoren tiparet, fillimi i ciklit jetësor dhe përfundimi i ciklit jetësor, vlera e përfundimi i ciklit jetësor nuk do të vendosen para vlerës së fillimit të ciklit jetësor.

c) Për më tepër, do të përdoren të gjitha kërkesat me motive specifike të përcaktuara në standardet përkatëse për çdo temë.

11. Metadatat e kërkuara për ndërveprimin

Metadatat përshkruajnë një grup të dhënash



gjeohapësinore të cilat do të përfshijnë elementet e mëposhtme të metadatave, që kërkohen për ndërveprimin:

a) Sistemi koordinativ i referimit: Përshkrimi i sistemit/eve koordinativ/e të referimit të përdorura për grupin e të dhënave;

b) Sistemi i referencës kohore: Përshkrimi i sistemit/eve kohor/e të referimit të përdorura në grupin e të dhënave.

Ky element është i detyrueshëm vetëm nëse grupi i të dhënave gjeohapësinore përmban informacion kohor, që nuk i referohet sistemit të referencës kohore, të zgjedhur më parë.

a) Shërbim kodimi: Shërbim që ofron implementimin e rregullave të kodimit dhe ofron një ndërfaqe për funksionalitetet e kodimit dhe dekodimit. (Sipas vendimit nr. 1077, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë”).

b) Konsistenca topologjike: Korrektësia e karakteristikave të koduara topologjike në mënyrë të qartë të grupit të të dhënave, siç përshkruhet nga domain.

Ky element është i detyrueshëm vetëm nëse grupi i të dhënave përfshin tipa nga modeli i përgjithshëm i rrjetit dhe nuk garanton topologji qendrore (lidhje me qendrat) për rrjetin.

a) Kodimi i karakterit: Kodimi i karakterit të përdorur në grupin e të dhënave. Ky element është i detyrueshëm vetëm nëse një kodim përdoret dhe nuk bazohet në UTF-8.

b) Tipi i prezantimit gjeohapësinor: Metoda e përdorur për të prezantuar në mënyrë gjeohapësinore informacionin gjeografik.

12. Paraqitja

12.1. Për paraqitjen e grupeve të të dhënave gjeohapësinore, që përdorin një shërbim rrjeti sipas “Rregullave të shërbimeve të rrjetit” do të vihen në dispozicion:

a) shtresat (*layers*), të specifikuar në standardet përkatëse për çdo temë për motivin ose motivet me të cilat lidhet grupi i të dhënave;

b) për secilën shtresë të paktën një stil paraqitjeje me parazgjedhje, duke pasur minimumi një titull shoqërimi dhe një identifikues unik.

12.2 Për secilën shtresë, standardi përkatës i temës përcakton:

a) një titull të lexueshëm nga njeriu, i shtresës për t'u përdorur për shfaqje në ndërfaqen e përdoruesit;

b) Tipi /et i objektit gjeohapësinor ose nëntipi, që përbën/jnë përmbajtjen e shtresës.

12.3 Për tipat e objekteve gjeohapësinore, objektet e të të cilave mund të klasifikohen më tej duke përdorur një atribut si kod-listë, mund të përcaktohen disa shtresa. Secila nga këto shtresa do të përfshijë objektet gjeohapësinore, që korrespondojnë me njërën nga vlerat specifike të kod-listës. Në përkufizimin e grupeve të shtresave në standardet përkatëse sipas temave do të përmbushen të gjitha kërkesat e mëposhtme:

a) variabli <Vlera e kod-listës> përfaqëson vlerat e kod-listës përkatëse, ku shkronja e parë është kapitale;

b) variabli <Lexueshmëria e emrit> përfaqëson emrin e lexueshëm nga njeriu të vlerave të kod-listës;

c) tipi i objektit gjeohapësinor përfshin atributin përkatës dhe kod-listën, në thonjëza;

ç) do të jepet një shembull i shtresës.

KREU III

TIPAT E ZAKONSHËM, PËRKUFIZIMET DHE KËRKESAT

1. TIPAT E PËRCAKTUAR NË STANDARDET EVROPIANE DHE NDËRKOMBËTARE

Tipat e mëposhtëm, të përdorur më shpesh si attribute apo role shoqërimi të tipave, të objekteve gjeohapësinore ose të tipave të të dhënave gjeohapësinore, përkufizohen si vijon:

1.1. Për tipat: Kënd, sipërfaqe, tipi boolean, varg karakteresh, datë, data-ora, tipi decimal, distancë, tipi integer, gjatësi, matje, numër, probabilitet, real, tipi i regjistrimit, nënshkrim, njësi matëse, shpejtësi dhe volum do të zbatohen përkufizimet e dhëna në ISO/TS 19103:2005.

1.2 Për tipat: (*Direct Position*), (*GM_Boundary*), (*GM_Curve*), (*GM_MultiCurve*), (*GM_MultiSurface*), (*GM_Object*), (*GM_Point*), (*GM_Primitive*), (*GM_Solid*), (*GM_Surface*) dhe (*GM_Tin*) do të përdoren përkufizimet e dhëna në standardet përkatëse sipas temave.



1.3 Për tipat: (TM_Duration), (TM_Geometric - Primitive), (TM_Instant), (TM_Object), (TM_Period) dhe (TM_Position) do të zbatohen përkufizimet e dhëna në EN ISO 19108:2005 /AC:2008.

1.4 Për tipin (GF_PropertyType) do të zbatohen përkufizimet e dhëna në EN ISO 19109:2006.

1.5 Për tipat: (CI_Citation), (CI_Date), (CI_RoleCode), EX_Extent, EX_VerticalExtent, MD_Distributor, MD_Resolution dhe URL do të zbatohen përkufizimet e dhëna në EN ISO 19115:2005/AC:2008.

1.6 Për tipin (CV_SequenceRule) do të zbatohen përkufizimet e dhëna në EN ISO 19123:2007.

1.7 Për tipat: (AbstractFeature), (Quantity and Sign) do të zbatohen përkufizimet e dhëna në EN ISO 19136:2009.

1.8 Për tipat: (LocalisedCharacterString), (PT_FreeText) dhe URI do të zbatohen përkufizimet e dhëna në EN ISO/TS 19139:2009.

1.9 Për tipin *LC_LandCoverClassificationSystem* do të zbatohen përkufizimet e dhëna në ISO 19144-2:2012.

1.10 Për tipat: (GFI_Feature), (Location), (OM_Observation), (OM_Process), *Sampling-Coverage Observation*, *SF_SamplingCurve*, *SF_Sampling Point*, *SF_SamplingSolid*, *SF_SamplingSurface* dhe *SF_Spatial SamplingFeature* do të zbatohen përkufizimet e dhëna në ISO 19156:2011.

1.11 Për tipat: Kategori, sasi, gamë e sasisë dhe kohë do të zbatohen përkufizimet e dhëna sipas standardeve INSPIRE.

1.12 Për tipat *TimeValuePair* dhe *Timeseries* shpjegimi jepet sipas përkufizimeve të standardeve INSPIRE.

1.13 Për tipat *CGI_LinearOrientation* dhe *CGI_PlanarOrientation* shpjegimi jepet sipas përkufizimeve të standardeve INSPIRE.

2. DATA-TYPE TË PËRBASHKËTA

2.1 Identifikuesi

Identifikuesi i jashtëm i një objekti unik, të publikuar nga autoriteti përgjegjës, që mund të përdoret nga aplikimet e jashtme, referuar objektit gjeohapësinor.

Atributet e identifikuesit të *data-type*-ve

Atributi	Përkufizimi	Tipi	Shmangia
ID lokale	Një identifikues lokal, caktuar nga ofruesi i të dhënave. Identifikuesi lokal është unik brenda emrit, kjo do të thotë se nuk ka objekt tjetër gjeohapësinor që mbart të njëjtin identifikues unik.	Vargu i karaktereve	
Emri i krijuesit	Emri që identifikon në mënyrë unike burimin e të dhënave të objektit gjeohapësinor.	Vargu i karaktereve	
ID e versionit	Identifikuesi i versionit të veçantë të objektit gjeohapësinor, me një gjatësi maksimale prej 25 karakteresh. Nëse specifikimi i një tipi të objektit gjeohapësinor me një identifikues të jashtëm objekti përfshin informacionin e ciklit të jetës, versioni identifikues përdoret për të dalluar mes versioneve të ndryshme të një objekti gjeohapësinor. Brenda grupit të të gjitha versioneve të një objekti gjeohapësinor, versioni identifikues është unik.	Vargu i karaktereve	i shmangshëm



2.2 Palët përgjegjëse (*RelatedParty*)

Një autoritetit përgjegjës ose një person me një status të caktuar, që lidhet me një burim.

Atributet e identifikuesit të *data-type*-ve

Atributi	Përkufizimi	Tipi	Shmangia
Emri individual	Emri i personit përkatës.	Tekst i lirë PT	i shmangshëm
Autoriteti përgjegjës	Emri i autoritetit përgjegjës sipas vendimit të ASIG-ut.	Tekst i lirë PT	i shmangshëm
Titulli i pozicionit	Pozicioni i palës pjesëmarrëse në lidhje me një burim, siç është kreu i departamentit.	Tekst i lirë PT	i shmangshëm
Kontakti	Informacioni i kontaktit për palën pjesëmarrëse përkatëse.	Kontakti	i shmangshëm
Roli	Rolet e palës pjesëmarrëse në lidhje me një burim, siç është pronari.	Vlera e rolit të palës	i shmangshëm

2.3 Kufizimet e të dhënave të kontaktit për palët përgjegjëse.

Të paktën do të jepet individi, autoritetit përgjegjës ose emërtimi i pozicionit.

Kontakti

Kanalet e komunikimit me të cilat është e mundur marrja e aksesit për dikë ose diçka.

Atributet e identifikuesit të tipi të të dhënave të kontaktit

Atributi	Përkufizimi	Tipi	Shmangia
Adresa	Adresë e dhënë si tekst i lirë.	Paraqitja e adresës	i shmangshëm
Udhëzimet e kontaktit	Udhëzime shtesë se si apo kur të kontaktoni një individ ose organizatë.	Tekst i lirë PT	i shmangshëm
Adresa e postës elektronike	Adresa e kutisë së postës elektronike të një organizate ose individi.	Vargu i karaktereve	i shmangshëm
Orët e shërbimit	Periudhat kohore kur autoriteti përgjegjës apo individi mund të kontaktohet.	Tekst i lirë PT	i shmangshëm
Telefoni fax-e-mail	Nr. i telefonit fax-email të autoritetit përgjegjës ose individit.	Vargu i karaktereve	i shmangshëm
Telefon	Numri i telefonit të autoritetit përgjegjës ose individit.	Vargu i karaktereve	i shmangshëm
Website zyrtar	Faqet e ofruara në web nga autoriteti përgjegjës ose individi.	URL	i shmangshëm



2.4 Citim i dokumenti (*DocumentCitation*)

Citim për qëllim të referimit të qartë të një dokumenti.

Atributet e *data-type*-ve për citimin e dokumentit

Atributi	Përkuftizimi	Tipi	Shmangia
Emri	Emri i dokumentit.	Vargu i karaktereve	
Emri i shkurtuar	Emër i shkurtër ose titull alternativ i dokumentit.	Vargu i karaktereve	i shmangshëm
Data	Data e krijimit, botimit ose rishikimit të dokumentit.	CI_Date	i shmangshëm
Lidhja	Lidhja e një versioni <i>on-line</i> të dokumentit	URL	i shmangshëm
Referencë specifike	Referencë për një pjesë specifike të dokumentit.	Vargu i karaktereve	i shmangshëm

2.5 Citimi i legjislacionit (*LegislationCitation*)

Citim për qëllim të referimit të qartë të një akti ligjor ose një pjese specifike të një akti ligjor.

Ky tip është një nëntip i citimit të dokumentit.

Atributet e *data-type*-ve të citimit të legjislacionit

Atributi	Përkuftizimi	Tipi	Shmangia
Numër identifikimi	Kodi i përdorur për të identifikuar instrumentin legjislativ	Vargu i karaktereve	
Nr. i dokumentit zyrtar	Numri i dokumentit zyrtar i përdorur për të identifikuar në mënyrë unike instrumentin legjislativ.	Vargu i karaktereve	
Data e hyrjes në fuqi	Data e instrumentit legjislativ të hyrë në fuqi.	TM Position	
Data e shfuqizimit	Data e shfuqizimit të instrumentit legjislativ	TM Position	
Niveli	Niveli me të cilin është miratuar instrumenti legjislativ.	Vlera e nivelit	
Citimi i faqes zyrtare	Citimi i faqes zyrtare me të cilën është botuar legjislacioni. (www.qbz.gov.al)	Gazeta zyrtare në formim	

Atributet e *data-type*-ve të citimit të legjislacionit

Nëse atributi i lidhjes është i pavlefshëm, do të ofrohet citimi nga faqja zyrtare.

2.6 Informacioni i Fletores Zyrtare

Citim i plotë i vendndodhjes së instrumentit legjislativ brenda faqes zyrtare.

**Atributet e *data-type*-ve të informacionit në Fletoren Zyrtare**

Atributi	Përkufizimi	Tipi	Shmangia
Identifikimi i faqes zyrtare	Referencë për vendndodhjen brenda gazetës zyrtare brenda së cilës është botuar instrumenti legjislativ. Kjo referencë do të përbëhet nga tre pjesë: titulli i gazetës zyrtare volumi dhe/ose numri i serisë Numri(at) e faqes	Vargu i karaktereve	
ISSN	Numri serial i Standardit Ndërkombëtar (ISSN) është një numër tetëshifror, që identifikon publikimin periodik në të cilën është botuar instrumenti legjislativ.	Vargu i karaktereve	
ISBN	Numri i librit të Standardit Ndërkombëtar (ISBN) është një numër nëntëshifror, që identifikon në mënyrë unike librin në të cilën është botuar instrumenti legjislativ.	Vargu i karaktereve	
Linku i faqes zyrtare	Lidhja me një version <i>on-line</i> të Fletores Zyrtare	URL	

2.7 Identifikuesi tematik

Identifikuesi tematik që do të identifikojë në mënyrë unike objektin gjeohapësinor.

Atributet e *data-type*-ve të identifikuesit tematik

Atributi	Përkufizimi	Tipi	Shmangia
Identifikuesi	Identifikuesi unik i përdorur për të identifikuar objektin gjeohapësinor brenda skemës së specifikuar të identifikimit.	Vargu i karaktereve	
Skema e identifikuesit	Identifikuesi që përcakton skemën e përdorur për të caktuar identifikuesin.	Vargu i karaktereve	

3. NUMËRTIMET E PËRBASHKËTA**3.1 Vlerat e pozicionit vertikal**

Vlera	Përkufizimi
Në sipërfaqen e tokës	Objekti gjeohapësinor është në nivelin e tokës
Ndërmjetëm	Objekti gjeohapësinor është pezull ose në hapësirë
Nëntokë (nën ujë)	Objekti gjeohapësinor është nëntokësor (nënujor)

Pozicioni vertikal përkatës i një objekti gjeohapësinor.

Vlerat e lejuara për numërtimet e pozicionuara vertikalisht.

4. KOD-LISTAT E PËRBASHKËTA**4.1 Vlerat e gjendjes së objektit**

Gjendja e një objekti për sa i përket përfundimit dhe përdorimit të tij.

Vlerat e lejuara për këtë kod-listë përbëjnë vlerat në tabelën e mëposhtme dhe vlerat më të domosdoshme, përcaktuar nga ofruesit e të dhënave.



Vlerat për kod-listën mbi gjendjen e objektit

Vlera	Emri	Përkufizimi
Funksional	funksional	Objekti është funksional.
Projektuar	projektuar	Objekti po projektohet. Ndërtimi nuk ka filluar ende.
Proces ndërtimi	proces ndërtimi	Objekti është në ndërtim e sipër dhe nuk është ende funksional. Kjo përdoret vetëm për ndërtimin fillestar të objektit dhe jo për mirëmbajtjen e punës.
Nxjerrë nga përdorimi	nxjerrë nga përdorimi	Objekti nuk përdoret më, por nuk po hiqet dhe nuk është hequr nga shërbimi.
Hequr nga shërbimi	hequr nga shërbimi	Objekti nuk përdoret më dhe nuk po hiqet dhe nuk është hequr nga shërbimi.

4.2 Kodi i shtetit

Kodi i shtetit siç është përcaktuar në udhërrëfyesin e stilit ndërinstitucional, botuar nga Zyra e Botimeve të Bashkimit Evropian.

Vlerat e lejuara për këtë kod-listë përbëhen vetëm nga vlerat e specifikuar në tabelën e mëposhtme.

Vlerat e lejuara për këtë kod-listë janë kodet me dy shkronja të shtetit të listuar në udhërrëfyesin e stilit ndërinstitucional, botuar nga Zyra e Botimeve të Bashkimit Evropian.

4.3 Niveli i legjislacionit

Niveli me të cilin është miratuar një akt ligjor ose konventë.

Vlerat e lejuara për këtë kod-listë përbëhen nga vlerat e përcaktuara nga ofruesit e të dhënave.

Ofruesit e të dhënave mund të përdorin vlerat e specifikuar në standardet përkatëse për çdo temë, sipas udhëzuesve teknikë të INSPIRE-s.

4.4 Roli i palës përgjegjëse

Rolet e palëve pjesëmarrëse që lidhen ose janë përgjegjëse për një burim të caktuar.

Vlerat e lejuara për këtë kod-listë përbëjnë vlerat në kod-listat e mëposhtme ose kod-listat e tjera të përcaktuara nga ofruesit e të dhënave.

- *Role Code (CI_RoleCode)*: Funksionet e kryera nga një palë përgjegjëse, e specifikuar si në EN ISO 19115:2005/AC:2008.

- Roli i një pale përgjegjëse (*RelatedPartyRoleValue*): Klasifikimi i roleve që lidhen me palën përgjegjëse, siç specifikohet në tabelën e mëposhtme.

Vlerat për kod-listën për rolin e palës përgjegjëse

Vlera	Emri	Përkufizimi
Autoriteti	autoriteti	Një autoritet mandatar me ligj për të mbikëqyrur një burim dhe/ose palët lidhur me një burim të caktuar.
Operator	operator	Një autoritet i cili mbart një burim.
Pronari	pronari	Një autoritet i cili zotëron një burim, i përket një burim nga ana ligjore.

4.5 Emrat standart të klimës dhe parashikimit të motit

Përkufizimet e fenomeneve të vëzhguara në meteorologji dhe oqeanografi.

Vlerat e lejuara për këtë kod-listë përbëhen nga vlerat e përcaktuara nga ofruesit e të dhënave.

Ofruesit e të dhënave mund të përdorin vlerat e specifikuar në standardet përkatëse sipas temave në përputhje me dokumentet teknike të INSPIRE në Modelin e Përgjithshëm Konceptual të INSPIRE-s.

Gjinia

Gjinia e një personi ose grupi personash.



Vlerat e lejuara për këtë kolistë përbëhen vetëm nga vlerat e specifikuar në tabelën e mëposhtme.

Vlerat e kod-listës së gjinisë

5. MODEL I PËRGJITHSHËM I RRJETIT

Vlera	Emri	Përkufizimi
Femër	femër	Një person ose grup personash të seksit femër.
Mashkull	mashkull	Një person ose grup personash të seksit mashkull.
I pacaktuar	i pacaktuar	Një person ose grup personash të një seksi të pacaktuar.

5.1 Tipat e objektit gjeohapësinor

5.1.1 Referencë e tërthortë (*CrossReference*)

Përfaqëson një referencë mes dy elementeve në të njëjtin rrjet.

Rolet e shoqërimit të tipit të objektit gjeohapësinor me referencë të tërthortë

Rol shoqërimi	Përkufizimi	Tipi	Shmangia
Elementi	Elementet e referencës së tërthortë	Elementi i rrjetit	

5.1.2 Lidhje e përgjithësuar (*GeneralisedLink*)

Tipi me bazë abstrakte përfaqëson një element rrejt linear, i cili mund të përdoret si një target në referencat lineare.

Ky tip është një nëntip i elementit të rrjetit.

Ky tip është abstrakt.

5.1.3 Kategoritë e kryqëzimeve të ndara (*GradeSeparated- Crossing*)

Tregon se cili nga dy ose më shumë elementet që kryqëzohen është/janë poshtë dhe cili/cilët është/janë sipër, për t'u përdorur nëse kuotat nuk janë të pranishme ose nuk janë të besueshme.

Ky tip është një nëntip i elementit të rrjetit.

Rolet e shoqërimit të tipit të objektit gjeohapësinor për ndarjen në kategori të elementeve të kryqëzuara. (*GradeSeparated- Crossing*)

Rol shoqërimi	Përkufizimi	Tipi	Shmangia
Elementi	Rendi i lidhjeve të kryqëzimit. Rendi reflekton lartësia e tyre; lidhja e parë është lidhja e poshtme.	lidhje	

5.1.4 Lidhja

Elementet të kurbëzuara linearisht të rrjetit të cilat lidhin dy pozicione dhe që përfaqëson një rrugë homogjene në rrjet. Pikat e lidhura mund të paraqiten si nyje.

Ky tip është një nëntip i lidhjes së përgjithësuar.

Ky tip është abstrakt.



Atributet e objektit gjeohapësinor të tipit lidhje (*Link*)

Atributi	Përkufizimi	Tipi	Shmangia
Gjeometria e linjës qendrore (aksi)	Gjeometri që përfaqëson linjën qendrore të lidhjes.	<i>GM_Curve</i>	
Imagjinare	Tregues që gjeometria qendrore e lidhjes është një vijë e drejtë pa pika të ndërmjetme kontrolli - nëse vija e drejtë nuk përfaqëson gjeografinë në zgjidhjen siç duhet të grupit të të dhënave.	<i>Boolean</i>	

Rolet e shoqërimit të tipit të objektit gjeohapësinor *link*

Rol shoqërimi	Përkufizimi	Tipi	Shmangia
Nyja fundore	Nyja opsionale fundore për këtë lidhje. Nyja fundore mund të jetë shembulli i njëjtë si nyja e fillimit.	Nyja	
Nyja fillestare	Nyja opsionale e fillimit për këtë lidhje.	Nyja	

5.1.5 Lidhje sekuenciale

Një element rrjeti që përfaqëson një rrugë të vazhdueshme në rrjet pa ndonjë degëzim. Elementi ka një fillim dhe fund të përcaktuar dhe çdo pozicion në rendin e lidhjes është i identifikueshëm me njërin nga parametrat siç është gjatësia.

Ky tip është një nëntip i lidhjes së përgjithësuar.

Ky tip është abstrakt.

Atributet e objektit gjeohapësinor të tipit lidhje sekuenciale

Rol shoqërimi	Përkufizimi	Tipi	Shmangia
Lidhja	Grupi i lidhjeve dhe rendet e përbëjnë grupin e lidhjes.	<i>GeneralisedLink</i>	

5.1.6 Objekt lidhës (*LinkSet*)

Një koleksion i rendeve të lidhjes dhe/ose lidhjet individuale që kanë një funksion specifik ose domethënie në një rrjet.

Ky tip është një nëntip i elementit të rrjetit.

Ky tip është abstrakt.

Rolet e shoqërimit të tipit të objektit gjeohapësinor (*LinkSet*)

Rol shoqërimi	Përkufizimi	Tipi	Shmangia
Lidhja	Grupi i lidhjeve dhe rendet e përbëjnë grupin e lidhjes.	<i>GeneralisedLink</i>	



5.1.7 Rrjeti

Një rrjet është ndërlidhja e elementeve të rrjetit.

Atributet e tipit të objektit gjeohapësinor në rrjet

Atributi	Përkufizimi	Tipi	Shmangia
Emërtimet gjeografike	Emri gjeografik për këtë rrjet.	<i>GeographicalName</i>	i shmangshëm

Rolet e shoqërimit të tipit të objektit gjeohapësinor në rrjet

Rol shoqërimi	Përkufizimi	Tipi	Shmangia
Elementet	Koleksioni i elementeve që përbëjnë rrjetin.	Elementi i rrjetit	

5.1.8 Sipërfaqja e rrjetit (*Network*)

Element 2-dimensional në një rrjet.

Ky tip është një nëntip i elementit të rrjetit.

Ky tip është abstrakt.

Atributet e tipit të objektit gjeohapësinor (*NetworkArea*)

Atributi	Përkufizimi	Tipi	Shmangia
Gjeometria	Përfaqëson karakteristikat gjeometrike të zonës	Sipërfaqja GM	

5.1.9 Lidhje në rrjet

Përfaqëson një lidhje logjike mes dy ose më shumë elementeve të rrjetit në rrjete të ndryshme.

Ky tip është një nëntip i elementit të rrjetit.

Atributet e lidhjes në rrjet për tipin e objektit gjeohapësinor.

Atributi	Përkufizimi	Tipi	Shmangia
Tipi	Kategorizimi i lidhjes së rrjetit.	Lidhja-Tipi i vlerës	i shmangshëm

Rolet e shoqërimit të tipit të objektit gjeohapësinor (*NetworkConnection*)

Rol shoqërimi	Përkufizimi	Tipi	Shmangia
Elementi	Elementet e rrjetit në rrjete të ndryshme	Elementi i rrjetit	

Kufizimet e lidhjes së rrjetit në bazë të tipit të objektit gjeohapësinor.

Të gjitha elementet duhet të jenë në rrjete të ndryshme

5.1.10 Element rrjeti

Tipi bazik që përfaqëson një element në rrjet. Çdo element në një rrjet ofron disa funksione që janë në interes të rrjetit.

Ky tip është abstrakt.

**Atributet e elementeve të rrjetit për tipin e objektit gjeohapësinor**

Atributi	Përkufizimi	Tipi	Shmangia
Koha e fillimit të Versionit	Data dhe koha kur ky version i objektit gjeohapësinor u vendos ose u ndryshua në grupin e të dhënave gjeohapësinore.	data ora	i shmangshëm
Koha e përfundimit të versionit	Data dhe koha kur ky version i objektit gjeohapësinor u zëvendësua ose u tërhoq nga grupi i të dhënave gjeohapësinore.	data ora	i shmangshëm
ID Inspire	Identifikuesi i jashtëm i objektit gjeohapësinor.	Identifikuesi	

Rolet e shoqërimit të tipit të objektit gjeohapësinor për elemente të rrjetit

Rol shoqërimi	Përkufizimi	Tipi	Shmangia
Në rrjet	Rrjetet ku një element rrjeti është pjesëtar.	Rrjeti	i shmangshëm

5.1.11 Karakteristikat e rrjetit

Tipi bazë abstrakt që përfaqëson fenomenin e gjendur në ose përgjatë elementit të një rrjeti. Ky tip bazë ofron karakteristika të përgjithshme për të shoqëruar fenomenin e lidhur me rrjet (karakteristikat e rrjetit) me elementet e rrjetit.

Ky tip është abstrakt.

Atributet e tipit të objektit gjeohapësinor në rrjet

Atributi	Përkufizimi	Tipi	Shmangia
